

Orig.English / vers. Albanian  
Unofficial, unrevised translation



COUNCIL OF EUROPE    CONSEIL DE L'EUROPE

*Seria e traktateve evropiane - 78A*

**MARRËVESHJA PLOTËSUESE  
PËR ZBATIMIN E  
KONVENTËS EVROPIANE  
TË SIGURIMEVE SHOQËRORE**

**Paris, 14.XII.1972**

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të Konventës evropiane të sigurimeve shoqërore dhe të kësaj Marrëveshjeje plotësuese,

Duke patur parasysh se në bazë të paragrafit 1 të nenit 80 të Konventës evropiane të sigurimeve shoqërore, zbatimi i kësaj të fundit rregullohet nëpërmjet dispozitave të një Marrëveshjeje plotësuese,

U morën vesh për sa më poshtë :

### **Pjesa I – Dispozita të përgjithshme**

#### **Neni 1**

Për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje plotësuese :

- a termi « Konventë » përcakton Konventën evropiane të sigurimeve shoqërore ;
- b termi « Marrëveshje » përcakton Marrëveshjen plotësuese për zbatimin e Konventës ;
- c termi « Komitet » përcakton Komitetin e ekspertëve në fushën e sigurimeve shoqërore të Këshillit të Evropës apo çdo komitet tjetër që Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës mund ta ngarkojë për plotësimin e detyrave të përmendura në nenin 2 të Marrëveshjes ;
- d termi « punonjës stinor » përcakton një punonjës që shkon në territorin e një Pale kontraktuese i ndryshëm nga territori ku banon, për të kryer, për llogari të një ndërmarrjeje apo të një punëdhënësi të kësaj Pale, një punë me karakter stinor, zgjatja e së cilës nuk duhet t'i kalojë tetë muaj, dhe që qëndron në territorin e Palës në fjalë për aq kohë sa zgjat puna e tij ; me punë e karakterit stinor duhet kuptuar një punë që varet nga ritmi i stinëve dhe që përsëritet vetvetiu çdo vit ; për ligjia e cilësimit stinor bëhet nëpërmjet kontratës së punës përcaktuar nga shërbimet e punësimit të Palës kontraktuese në territorin e së cilës punonjësi stinor shkon për të ushtruar veprimtarinë e tij apo me anë të një dokumenti që lëshohet nga këto shërbime dhe që vërteton se personi përkatës ushtron një punë stinore në këtë territor ;
- e termat e përkufizuar në nenin 1 të Konventës kanë kuptimin që u është dhënë nga vetë ky nen.

#### **Neni 2**

- 1 Modelet e vërtetimeve, dëshmimeve, deklarimeve, kërkesave dhe dokumenteve të tjera të nevojshme për zbatimin e Konventës dhe të Marrëveshjes vendosen nga Komiteti. Nëse dy a më shumë Palë kontraktuese bien në ujdi për të përdorur modele të tjera të këtyre dokumenteve, ato vënë në dijeni Komitetin për një gjë të tillë.

- 2 Komiteti mund të mbledhë, me kërkesë të autoriteteve kompetente të çdo Pale kontraktuese, të dhëna mbi dispozitat e legjislacioneve ku gjen zbatim Konventa.
- 3 Komiteti mund të përgatisë broshura orientuese për t'u bërë të njohur të interesuarve të drejtat e tyre, si dhe formalitetet administrative që duhet të plotësojnë për parashtrimin e këtyre të drejtave.

### **Neni 3**

- 1 Autoritetet kompetente të Palëve kontraktuese mund të përcaktojnë organizmat ndërlidhës që mund të komunikojnë drejtpërdrejt mes tyre, si dhe me institucionet e çdo Pale kontraktuese, me kusht që të jenë të autorizuar për këtë nga autoriteti kompetent i kësaj Pale.
- 2 Çdo institucion i një Pale kontraktuese, si dhe çdo person që e ka vendbanimin apo vendqëndrimin në territorin e një Pale kontraktuese, mund t'i drejtohet institucionit të një Pale tjetër kontraktuese, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet organizmave ndërlidhës.

### **Neni 4**

- 1 Shtojca 1 përcakton autoritetin kompetent apo autoritetet kompetente të çdo Pale kontraktuese.
- 2 Shtojca 2 përcakton institucionet kompetente të çdo Pale kontraktuese.
- 3 Shtojca 3 përcakton institucionet e vendbanimit dhe institucionet e vendqëndrimit të çdo Pale kontraktuese.
- 4 Shtojca 4 përcakton organizmat ndërlidhës të caktuar nga autoritetet kompetente të Palëve kontraktuese në bazë të paragrafit 1 të nenit 3 të Marrëveshjes.
- 5 Shtojca 5 përcakton dispozitat e parashikuara në nënparagrafin b të nenit 6 dhe në paragrafin 2 të nenit 46 të Marrëveshjes.
- 6 Shtojca 6 përcakton emrin dhe selinë e bankave të përmendura në paragrafin 1 të nenit 48 të Marrëveshjes.
- 7 Shtojca 7 përcakton institucionet e ngarkuara nga autoritetet kompetente të Palëve kontraktuese mbështetur në dispozitat e paragrafit 1 të nenit 7, të paragrafit 1 të nenit 12, të paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 14, të nenit 34, të paragrafit 1 të nenit 57, të paragrafit 1 të nenit 63, të paragrafit 2 të nenit 72, të paragrafit 2 të nenit 73, të nenit 76, të nenit 77, të paragrafit 2 të nenit 78, të paragrafit 1 të nenit 83, të nenit 84 dhe të paragrafit 2 të nenit 87 të Marrëveshjes.

### **Neni 5**

Dy a më shumë Palë kontraktuese mund të vendosin, me ujdë të përbashkët, për aq sa u takon, për modalitete zbatimi të ndryshme nga ato që parashikon Marrëveshja.

**Neni 6**

Marrëveshja zëvendëson :

- a marrëveshjet lidhur me zbatimin e konventave të sigurimeve shoqërore zëvendësuar nga Konventa ;
- b dispozitat lidhur me zbatimin e dispozitave të konventave të sigurimeve shoqërore të përmendura në paragrafin 3 të nenit 6 të Konventës, mjaft që këto dispozita të mos jenë përmendur në Shtojcën 5.

**Pjesa II – Zbatimi i Pjesës I të Konventës****(Dispozita të përgjithshme)****Zbatimi i nenit 10 të Konventës****Neni 7**

- 1 Nëse, duke mbajtur parasysh dispozitat e nenit 10 të Konventës, i interesuari i plotëson kushtet e duhura për pranimin në sigurimin fakultativ të pandërprerë në rast invaliditeti, pleqërie apo vdekjeje (pensione) në kuadrin e shumë sistemeve, mbi bazën e legjislacionit të një Pale kontraktuese, dhe nëse nuk ka qenë objekt i sigurimit të detyrueshëm në një nga këto sisteme gjatë punësimit të tij të fundit, ai mund të përfitojë nga këto dispozita vetëm për t'u pranuar në sigurimin fakultativ të pandërprerë brenda sistemit që do t'i përgjigjej, sikur të kish pasur, nën legjislacionin e kësaj Pale, po atë punë që do përbënte objektin e sigurim-pensionit kur e ka ushtruar për herë të fundit nën legjislacionin e një Pale tjetër kontraktuese. Në rastin kur puna në fjalë nuk do sillte përfshirje në sigurimin e detyrueshëm sipas legjislacionit të Palës së parë apo nëse nuk është e mundur të përcaktohet natyra e kësaj pune, autoriteti kompetent i kësaj Pale apo institucioni i ngarkuar prej tij përcakton sistemin në të cilin mund të vazhdohet sigurimi fakultativ.
- 2 Për të përfituar nga dispozitat e nenit 10 të Konventës, i interesuari paraqet tek institucioni i Palës kontraktuese përkatëse një vërtetim lidhur me periudhat e sigurimit të kryera nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, si dhe, në rast nevojë, lidhur me periudhat e banimit të kryera pas moshës gjashtëmbëdhjetë vjeç nën legjislacionin me karakter jo kontributiv të çdo Pale tjetër kontraktuese. Ky vërtetim jepet, me kërkesë të të interesuarit apo të institucionit përkatës, nga institucioni apo nga institucionet pranë të cilave ai ka kryer periudhat për të cilat bëhet fjalë.

**Zbatimi i nenit 13 të Konventës****Neni 8**

Kur përfituesi i një të ardhure që mbështetet në legjislacionin e një Pale kontraktuese ka gjithashtu të drejtë për të ardhura që mbështeten në legjislacionin e një apo më shumë Palëve të tjera kontraktuese, rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme :

- a në rastin kur zbatimi i dispozitave të paragrafit 2 të nenit 13 të Konventës do të sillte pakësim, pezullim apo heqje të njëhershme të këtyre të ardhurave, çdonjëra prej tyre nuk mund të pakësohet, pezullohet apo hiqet për një shumë më e lartë nga shuma që përftohet duke pjestuar shumën mbi të cilën mbështetet pakësimi, pezullimi apo heqja, në bazë të legjislacionit që e njeh këtë të ardhur, me numrin e të ardhurave objekt pakësimi, pezullimi apo heqjeje, për të cilat përfituesi ka të drejtë ;
- b megjithatë, nëse bëhet fjalë për të ardhura për invaliditet, pleqëri apo rast vdekjeje (pensione) të shlyera në përputhje me dispozitat e nenit 29 të Konventës nga institucioni i një Pale kontraktuese, ky institucion mban parasysht të ardhurat, pagat apo shpërblimet që mund të sjellin pakësim, pezullim apo heqje të ardhurës që i takon të japë, jo për përllogaritje të shumës teorike që përmendet në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 29 të Konventës, por vetëm për pakësim, pezullim apo heqje të shumës që përmendet në paragrafin 4 apo në paragrafin 5 të nenit 29 në fjalë ; megjithatë, këto të ardhura, paga apo shpërblime llogariten vetëm për një pjesë të shumës së tyre, përcaktuar në përpjestim me kohëzgjatjen e periudhave të kryera, në përputhje me dispozitat e paragrafit 4 të nenit 29 të Konventës ;
- c për zbatimin e dispozitave të paragrafit 2 të nenit 13 të Konventës, institucionet kompetente në fjalë, mbi bazë kërkese, i përcjellin shoshqit të gjitha të dhënat e duhura ;
- d për zbatimin e dispozitave të paragrafit 2 të nenit 13 të Konventës, kursi zyrtar i këmbimit që duhet marrë parasysht është kursi i vlefshëm ditën e parë të muajit gjatë të cilit kryet veprimi i fundit i shlyerjes apo, në rast nevoje, kursi i vlefshëm gjatë përllogaritjes së re të pensionit apo rentës.

**Neni 9**

Nëse një person apo një anëtar i familjes së tij mund të pretendojë për të ardhura për barrë lindje në bazë të legjislacionit të dy a më shumë Palëve kontraktuese, këto të ardhura jepen vetëm në bazë të legjislacionit të asaj Pale në territorin e së cilës ka ndodhur lindja apo, nëse lindja nuk ka ndodhur, në territorin e njërit prej këtyre Palëve, ekskluzivisht në bazë të legjislacionit në të cilin ky person ka qenë kohët e fundit objekt trajtimi.

**Neni 10**

- 1 Në rast vdekjeje të ndodhur në territorin e një Pale kontraktuese, ruhet vetëm e drejta për pagesë për vdekje që njeh legjislacioni i kësaj Pale, duke përjashtuar të drejtat që njeh legjislacioni i çdo Pale tjetër kontraktuese.

- 2 Në rast vdekjeje të ndodhur në territorin e një Pale kontraktuese, ndërkohë që e drejta për pagesë për vdekje njihet ekskluzivisht në bazë të legjislacioneve të dy a më shumë Palëve kontraktuese, apo në rast vdekjeje jashtë territorit të çdo Pale kontraktuese, ndërkohë që kjo e drejtë njihet në bazë të legjislacioneve të dy a më shumë Palëve kontraktuese, ruhet vetëm e drejta që njihet në bazë të legjislacionit të Palës kontraktuese, objekt i të cilit ka qenë kohët e fundit personi që çel të drejtën lidhur me këtë pagesë, duke përfshirë të drejtat që njihen në këtë drejtim në bazë të legjislacionit të çdo Pale tjetër kontraktuese.

#### **Neni 11**

Nëse, gjatë së njëjtës periudhë, dy a më shumë persona kanë të drejtë lidhur me pagesat për familje sipas legjislacioneve të dy a më shumë Palëve kontraktuese për të njëjtët anëtarë të familjes, Pala kontraktuese që ka për objekt të legjislacionit të saj mbështetësin kryesor të familjes konsiderohet si i vetmi shtet kompetent. Megjithatë, në rastin kur pagesat për familje njihen në bazë të legjislacionit të Palës kontraktuese në territorin e së cilës banojnë apo janë rritur fëmijët, për shkak të ushtrimit të një pune apo veprimtarie profesionale, kjo Palë konsiderohet si i vetmi shtet kompetent.

### **Pjesa III – Zbatimi i Pjesës II të Konventës**

#### **(Dispozita lidhur me legjislacionin e zbatueshëm)**

##### **Zbatimi i paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 15 të Konventës**

#### **Neni 12**

- 1 Në rastet e përmendura në nënparagrafin a.i. të paragrafit 1 dhe në nënparagrafin a të paragrafit 2 të nenit 15 të Konventës, institucioni i përcaktuar nga autoriteti kompetent i Palës kontraktuese, legjislacioni i së cilës mbetet i zbatueshëm, e pajis punonjësën me pagë, me kërkesë të këtij apo të punëdhënësit të tij, nëse kushtet e nevojshme janë plotësuar, me një dokument shkëputjeje, ku vërtetohet se ai mbetet objekt i këtij legjislacioni.
- 2 Marrëveshja e parashikuar në nënparagrafin a.ii të paragrafit 1 të nenit 15 të Konventës duhet të kërkohet nga punëdhënësi. Pëlqimi i punonjësit të interesuar është i nevojshëm kur këtë e parashikon legjislacioni i Palës kontraktuese të përmendur në paragrafin e mësipërm.

#### **Neni 13**

Kur, sipas nënparagrafit b apo nënparagrafit c të paragrafit 1 të nenit 15 të Konventës, legjislacioni i një Pale kontraktuese është i zbatueshëm për një punonjës me pagë, punëdhënësi i të cilit nuk ndodhet në territorin e Palës në fjalë, ky legjislacion zbatohet sikur ky punonjës të ishte i punësuar në vendin ku banon në territorin në fjalë, konkretisht për të përcaktuar institucionin kompetent.

##### **Zbatimi i nenit 17 të Konventës**

#### **Neni 14**

- 1 Dispozitat e paragrafit 1 të nenit 17 të Konventës mbeten të zbatueshme deri në datën e përzgjedhjes së parashikuar në paragrafin 2 të nenit 17 në fjalë.
- 2 Punonjësi me pagë që ushtron të drejtën e tij për përzgjedhje, vë në dijeni për këtë institucionin kompetent të Palës kontraktuese në territorin e së cilës ai është punësuar, si dhe institucionin e caktuar nga autoriteti kompetent i Palës kontraktuese për legjislacionin e së cilës ai ka bërë përzgjedhjen e vet, duke njoftuar njëkohësisht punëdhënësin e tij. Ky institucion vë në dijeni, në rast nevoje, çdo institucion tjetër të kësaj Pale të fundit, në përputhje me direktivat e lëshuara nga autoriteti kompetent i kësaj Pale.

## Unofficial, unrevised translation

- 3 Institucioni i caktuar nga autoriteti kompetent i Palës kontraktuese për legjislacionin e së cilës punonjësi me pagë ka bërë përzgjedhjen e vet, lëshon për këtë të fundit një dokument me anë të të cilit vërteton që ai është objekt i legjislacionit të kësaj Pale, ndërkohë që është me punë në misionin diplomatik apo në postin konsullor për të cilin bëhet fjalë, apo ndërkohë që është i punësuar në shërbim privat të zyrtarëve të këtij misioni apo posti.
- 4 Nëse punonjësi me pagë ka zgjedhur për zbatim legjislacionin e Palës kontraktuese, shtet akreditues apo shtet dërgues, dispozitat e këtij legjislacioni janë të zbatueshme sikur punonjësi me pagë të ishte i zënë me punë në vendin ku institucioni kompetent i Palës në fjalë të kishte selinë e vet.

**Pjesa IV - Totalizimi i periudhave të sigurimit dhe të banimit****Zbatimi i neneve 10, 19, 28, 49 dhe 51 të Konventës****Neni 15**

- 1 Në rastet e përmendura në nenin 10, në nenin 19, në paragrafët 1 deri në 4 të nenit 28, në nenin 49 dhe në paragrafët 1 deri në 3 të nenit 51 të Konventës, pa cënuar, në fund të fundit, dispozitat e paragrafit 4 të nenit 28 apo të paragrafit 3 të nenit 51 të Konventës, totalizimi i periudhave të sigurimit dhe të banimit kryet në përputhje me rregullat e mëposhtme :
  - a periudhave të sigurimit apo të banimit të kryera nën legjislacionin e një Pale kontraktuese i shtohen periudhat e sigurimit të kryera nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, si dhe, në rast nevojë, periudhat e banimit të kryera pas moshës gjashtëmbëdhjetë vjeç nën legjislacionin me karakter jo kontributiv të çdo Pale tjetër kontraktuese, për aq sa është e nevojshme që të plotësohen periudhat e sigurimit apo të banimit të kryera nën legjislacionin e Palës së parë, duke bërë kështu të mundur pranimin, ruajtjen dhe mbulimin e së drejtës për të ardhura, me kusht që këto periudha të mos përplasen me shoshoq ; nëse bëhet fjalë për të ardhura për invaliditet, pleqëri apo vdekje (pensione) që duhen shlyer nga institucionet e dy a më shumë Palëve kontraktuese sipas dispozitave të nenit 29 të Konventës, secila prej institucioneve në fjalë e bën këtë totalizim më vete, duke mbajtur parasysh tërësinë e periudhave të sigurimit apo të banimit që ka kryer i interesuari nën legjislacionet e të gjitha Palëve kontraktuese, kur ka qenë objekt i tyre ;
  - b kur një periudhë sigurimi e kryer mbi bazën e një sigurimi të detyrueshëm nën legjislacionin e një Pale kontraktuese përkon me një periudhë sigurimi të kryer mbi bazën e një sigurimi vullnetar apo fakultativ të pandërprerë nën legjislacionin e një Pale tjetër kontraktuese, vetëm e para merret parasysh, pa cënuar dispozitat e frazës së dytë të paragrafit 2 të nenit 16 të Konventës ;

- c kur një periudhë efektive sigurimi e kryer nën legjislacionin e një Pale kontraktuese përkon me një periudhë të asimiluar në periudhë efektive sigurimi në bazë të legjislacioni të një Pale tjetër kontraktuese, vetëm e para merret parasysh ;
  - d çdo periudhë që asimilohet në periudhë efektive sigurimi në bazë të legjislacioneve të dy a më shumë Palëve kontraktuese mbahet parasysh vetëm nga institucioni i asaj Pale nën legjislacionin e së cilës i interesuari ka qenë nënshtruar në mënyrë të detyrueshme për herë të fundit para periudhës në fjalë ; në rastin kur i siguruari nuk i është nënshtruar në mënyrë të detyrueshme legjislacionit të njërit prej këtyre Palëve para periudhës në fjalë, kjo periudhë merret parasysh nga institucioni i asaj Pale në legjislacionin e së cilës ai ka qenë i nënshtruar në mënyrë të detyrueshme për herë të parë pas periudhës në fjalë ;
  - e në rastin kur nuk mund të përcaktohet saktë koha në të cilën disa periudha sigurimi janë kryer nën legjislacionin e një Pale kontraktuese, kuptohet që këto periudha nuk duhet të përplasen me periudha të kryera nën legjislacionin e një Pale tjetër kontraktuese, dhe në këtë rast mbahen parasysh për aq sa mund të trajtohen në mënyrë të dobishme ;
  - f në rastin kur, sipas legjislacionit të një Pale kontraktuese, disa periudha sigurimi merren parasysh vetëm po qe se janë kryer brenda një afati të caktuar, institucioni që zbaton këtë legjislacion mban parasysh periudhat e kryera nën legjislacionin e një Pale tjetër kontraktuese vetëm nëse ato janë kryer brenda të njëjtit afat.
- 2 Periudhat e sigurimit të kryera nën sistemin e një Pale kontraktuese ndaj të cilit Konventa nuk gjen zbatim, por që merren parasysh nga një sistem tjetër i së njëjtës Palë për të cilin Konventa gjen zbatim, konsiderohen si periudha sigurimi që merren parasysh për të arritur totalizimin.
- 3 Kur periudhat e sigurimit të kryera nën legjislacionin e një Pale kontraktuese shprehen në njësi të ndryshme nga ato që përdoren nga legjislacioni i një Pale tjetër kontraktuese, shndërrimi i nevojshëm për qëllimet e totalizimit kryet sipas rregullave të mëposhtme :
- a nëse i interesuari ka ndjekur sistemin e javës prej gjashtë ditësh :
    - i një ditë është e barabartë me tetë orë, dhe e kundërta ;
    - ii gjashtë ditë janë të barabarta me një javë, dhe e kundërta ;
    - iii njëzet e gjashtë ditë janë të barabarta me një muaj, dhe e kundërta ;
    - iv tre muaj, apo trembëdhjetë javë, apo shtatëdhjetë e tetë ditë janë të barabarta me një tremujor, dhe e kundërta ;
    - v për shndërrimin e javëve në muaj dhe e kundërta, javët dhe muajt kthehen në ditë ;
    - vi zbatimi i rregullave të mësipërme nuk mund të bëjë të mundur të arrihet, për krejt periudhat e kryera gjatë një viti civil, një total më i lartë nga treqind e dymbëdhjetë ditë, apo gjashtëdhjetë e dy javë, apo dymbëdhjetë muaj, apo katër tremujorë;



**Unofficial, unrevised translation**

- 
- b nëse i interesuari ka ndjekur sistemin e javës prej pesë ditësh :
- i një ditë është e barabartë me nëntë orë, dhe e kundërta ;
  - ii pesë ditë janë të barabarta me një javë, dhe e kundërta ;
  - iii njëzet e dy ditë janë të barabarta me një muaj, dhe e kundërta ;
  - iv tre muaj, apo trembëdhjetë javë, apo shtatëdhjetë ditë janë të barabarta me një tremujor, dhe e kundërta ;
  - v për shndërrimin e javëve në muaj dhe e kundërta, javët dhe muajt kthehen në ditë ;
  - vi zbatimi i rregullave të mësipërme nuk mund të bëjë të mundur të arrihet, për krejt periudhat e kryera gjatë një viti civil, një total më i lartë nga dyqind e gjashtëdhjetë e katër ditë, apo pesëdhjetë e dy javë, apo dymbëdhjetë muaj, apo katër tremujorë.
- 4 Kur, në bazë të nënparagrafit b të paragrafit 1 të këtij neni, periudha sigurimi të kryera sipas një sigurimi vullnetar apo fakultativ të pandërprerë nën legjislacionin e një Pale kontraktuese, për invaliditet, pleqëri apo vdekje (pensione), nuk merren parasysh për të bërë totalizimin, kontributet që kanë të bëjnë me këto periudha konsiderohen si të destinuara për përmirësimin e të ardhurave që duhen dhënë në bazë të legjislacionit në fjalë. Nëse ky legjislacion parashikon një sigurim plotësues, kontributet në fjalë merren parasysh për llogaritjen e të ardhurave që duhen dhënë sipas një sigurimi të tillë.

**Pjesa V – Zbatimi i Pjesës III të Konventës****(Dispozita të veçanta për kategori të ndryshme të ardhurash)****Kreu 1 – Sëmundje e barrë lindje****Zbatimi i nenit 19 të Konventës****Neni 16**

- 1 Për të përfutuar nga dispozitat e nenit 19 të Konventës, i interesuari paraqet në institucionin kompetent një vërtetim ku pasqyrohen periudhat e sigurimit të kryera nën legjislacionin e Palës kontraktuese, së cilës i është nënshtruar më parë për herë të fundit dhe jep të gjitha të dhënat plotësuese që kërkon legjislacioni i institucionit të cilit i është drejtuar.
- 2 Vërtetimi i përmendur në paragrafin e mësipërm jepet, me kërkesë të të interesuarit, nga institucioni kompetent për sëmundjet i Palës kontraktuese, ku ai ka qenë më parë, për herë të fundit, objekt i legjislacionit të saj. Nëse i interesuari nuk paraqet vërtetimin në fjalë, institucioni kompetent i drejtohet këtij institucioni për ta marrë atë.

## Unofficial, unrevised translation

- 3 Nëse është e nevojshme të mbahen parasysh periudhat e sigurimit të kryera më parë nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese për të plotësuar kushtet që kërkohen nga legjislacioni i shtetit kompetent, dispozitat e paragrafëve të mësipërm të këtij neni zbatohen *mutatis mutandis*.

**Zbatimi i nenit 20 të Konventës****Neni 17**

- 1 Për të përfituar të ardhura në natyrë në bazë të nenit 20 të Konventës, i interesuari regjistrohet, sikurse edhe anëtarët e familjes së tij, pranë institucionit të vendbanimit, duke paraqitur një dokument me anë të të cilit vërtetohet se ai ka të drejtë për këto të ardhura, për veten e tij dhe për anëtarët e familjes së tij. Ky vërtetim jepet nga institucioni kompetent, në bazë të të dhënave të paraqitura, në rast nevojë, nga punëdhënësi. Nëse i interesuari apo anëtarët e familjes së tij nuk paraqesin vërtetimin në fjalë, institucioni i vendbanimit i drejtohet institucionit kompetent për ta marrë atë.
- 2 Vërtetimi i përmendur në paragrafin e mësipërm mbetet i vlefshëm për aq kohë sa institucioni i vendbanimit nuk ka marrë notifikim për anulimin e tij.
- 3 Nëse i interesuari ka cilësinë e punonjësit stinor, vërtetimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni është i vlefshëm gjatë gjithë periudhës së parashikuar për punën stinore, mjaft që institucioni kompetent nuk ka notifikuar ndërkohë anulimin e tij tek institucioni i vendbanimit.
- 4 Institucioni i vendbanimit njofton institucionin kompetent për çdo regjistrim që kryen, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.
- 5 Gjatë parashtrimit të kërkesës për të ardhura në natyrë, kërkuesi paraqet dokumentet e nevojshme që mbështesin kërkesën për dhënie të ardhurash në natyrë në bazë të legjislacionit të Palës kontraktuese në territorin e së cilës ai banon.
- 6 Në rast shtrimi në spital, institucioni i vendbanimit i notifikon institucionin kompetent, me t'u vënë në dijeni, datën e shtrimit në institucionin spitalor, kohëzgjatjen e mundshme të shtrimit dhe datën e daljes nga spitali.
- 7 I interesuari apo anëtarët e familjes së tij duhet të vënë në dijeni institucionin e vendbanimit për çdo ndryshim të gjendjes së tyre që mund të modifikojë të drejtën për të ardhura në natyrë, konkretisht çdo braktisje apo ndryshim të punës a veprimtarisë profesionale të të interesuarit, apo çdo transferim vendbanimi a vendqëndrimi të tij, apo të anëtarëve të familjes së tij. Institucioni kompetent njofton gjithashtu institucionin e vendbanimit për mbarimin e afatit regjistruar apo përfundimin e të drejtave për të ardhura të të interesuarit. Institucioni i vendbanimit mund t'i kërkojë në çdo kohë institucionit kompetent t'i paraqesë çdo të dhënë që ka të bëjë me regjistrimin apo me të drejtat për të ardhura të personit përkatës.

**Neni 18**

Kur bëhet fjalë për punonjës kufitarë apo për anëtarë të familjeve të tyre, medikamentet, fashimet, syzet, aparaturat e vogla, analizat dhe ekzaminimet laboratorike nuk mund të jepen a të kryhen veçse në territorin e Palës kontraktuese ku ata janë vizituar, sipas dispozitave ligjore të kësaj Pale.

**Neni 19**

- 1 Për të përfituar të ardhura në para në bazë të nënparagrafit b të paragrafit 1 të nenit 29 të Konventës, i interesuari i drejtohet institucionit të vendbanimit brenda një afati prej tri ditësh nga fillimi i paaftësisë për punë, duke paraqitur një dokument për ndalim të punës apo, nëse legjislacioni që zbaton institucioni kompetent apo institucioni i vendbanimit e parashikon, një vërtetim paaftësie për punë lëshuar nga mjeku specialist. Nga ana tjetër, ai duhet të paraqesë çdo dokument që kërkohet në bazë të legjislacionit të shtetit kompetent, sipas gjinisë të të ardhurave të kërkuara.
- 2 Kur mjekët specialistë të vendit të banimit nuk lëshojnë vërtetime paaftësie për punë, i interesuari i drejtohet drejtpërdrejt institucionit të vendbanimit, brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni që ai zbaton. Ky institucion hap menjëherë procedurën për të konstatuar nga ana mjekësore paaftësinë për punë dhe për lëshimin e vërtetimit që parashikohet në paragrafin paraprirës.
- 3 Institucioni i vendbanimit i përcjell pa afat institucionit kompetent dokumentet e përmendura në paragrafët e mësipërm të këtij neni, duke përcaktuar kohëzgjatjen e mundshme të paaftësisë për punë.
- 4 Me t'u bërë e mundur, institucioni i vendbanimit kryen kontrollin mjekësor dhe administrativ të të interesuarit dhe ia përcjell pa afat rezultatet e kontrollit institucionit kompetent, i cili ruan të drejtën për të bërë nga ana e vet ekzaminim të personit përkatës, nëpërmjet një mjeku të zgjedhur e të paguar prej tij. Nëse ky institucion i fundit vendos të mos i japë të ardhurat, sepse nuk janë respektuar nga i interesuari rregullat e kontrollit, ai e njofton personin me anë notifikimi për vendimin që ka marrë, duke i drejtuar njëkohësisht kopje vendimi institucionit të vendbanimit.
- 5 Përfundimi i paaftësisë për punë i notifikohet pa afat personit përkatës nga institucioni i vendbanimit, i cili njofton në çast institucionin kompetent. Kur ky i fundit vendos vetë që i interesuari është ribërë i aftë për punë, ai ia bën të ditur këtë vendim me anë notifikimi dhe i drejton njëkohësisht kopje vendimi institucionit të vendbanimit.
- 6 Nëse, për të njëjtin rast, janë përcaktuar, përkatësisht nga institucioni i vendbanimit dhe institucioni kompetent, dy data të ndryshme për përfundimin e paaftësisë për punë, mbahet parasysh data e përcaktuar nga institucioni kompetent.
- 7 Kur i interesuar rifillon punën, ai vë në dijeni për këtë institucionin kompetent, nëse një gjë e tillë parashikohet nga legjislacioni që zbaton ky institucion.
- 8 Institucioni kompetent i jep të ardhurat në para nëpërmjet tërë rrugëve të përshtatshme, konkretisht me mandatpostë ndërkombëtare, dhe njofton për këtë institucionin e vendbanimit. Nëse këto të ardhura shërbehen nga institucioni i vendbanimit për llogari të institucionit kompetent, institucioni kompetent njofton personin përkatës për të drejtat e tij sipas modaliteteve të parashikuara nga legjislacioni që ai zbaton, duke i treguar po ashtu institucionin e ngarkuar për shërbimin e të ardhurave në fjalë. Ai i bën të njohur njëkohësisht institucionit të vendbanimit shumën e të ardhurave, datën në të cilën ato duhet të shërbehen dhe kohëzgjatjen maksimale të dhënies së tyre, sikurse parashikohet nga legjislacioni i shtetit kompetent. Këmbimi i shumës të të ardhurave që duhet të shërbejë ky institucion i fundit kryet sipas kursit zyrtar të këmbimit i vlefshëm ditën e parë të muajit gjatë të cilit shërbehen këto të ardhura.

**Zbatimi i nenit 21 të Konventës****Neni 20**

- 1 Për të përfituar të ardhura në natyrë, për vete apo për anëtarët e familjes që e shoqërojnë gjatë shkëputjes që bën, punonjësi i përmendur në nënparagrafin a.i të paragrafit 1 apo në nënparagrafin a të

## Unofficial, unrevised translation

paragrafit 2 të nenit 15 të Konventës, i paraqet institucionit të vendqëndrimit vërtetimin e parashikuar në paragrafin 1 të nenit 12 të Marrëveshjes. Kur punonjësi në fjalë paraqet këtë vërtetim, kuptohet që ai ka përmbushur kështu kushtet për çeljen e së drejtës për të ardhura në natyrë.

- 2 Për të përfituar të ardhura në natyrë, për vete dhe për anëtarët e familjes që e shoqërojnë, punonjësi i përmendur në nënparagrafin b të paragrafit 1 të nenit 15 të Konventës, që është duke punuar në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, i paraqet sa më shpejt institucionit të vendqëndrimit një dëshmi të lëshuar nga punëdhënësi apo personi që vepron në emër të tij gjatë dy muajve civilë paraprirës. Kjo dëshmi paraqet konkretisht datën kur i interesuar ka filluar të punojë për llogari të punëdhënësit në fjalë, si dhe emërtesën dhe selinë e institucionit kompetent ; megjithatë, nëse, në bazë të legjislacionit të shtetit kompetent, punëdhënësi nuk ka pse ta njohë institucionin kompetent, punonjësi në fjalë jep me shkrim emërtesën dhe selinë e këtij institucioni sapo i drejton kërkesën institucionit të vendqëndrimit. Kur e paraqet këtë dëshmi, kuptohet që ai i ka përmbushur kushtet e nevojshme për çeljen e së drejtës për të ardhura në natyrë. Nëse nuk është në gjendje t'i drejtohet institucionit të vendqëndrimit para trajtimit mjekësor, ai përsëri përfiton nga ky trajtim me të paraqitur dëshminë në fjalë, sikur të ishte i siguruar pranë këtij institucioni.
- 3 Institucioni i vendqëndrimit i drejtohet pa vonesë institucionit kompetent për të mësuar nëse punonjësi i përmendur në paragrafin 1 apo në paragrafin 2 të këtij neni, sipas rastit, apo anëtarët e familjes të interesuar i plotësojnë kushtet e çeljes të së drejtës për të ardhura në natyrë. Ai duhet t'i japë këto të ardhura deri në marrjen e përgjigjes nga institucioni kompetent dhe jo më vonë se tridhjetë ditë.
- 4 Institucioni kompetent i drejton përgjigjen e vet institucionit të vendqëndrimit brenda gjashtë ditëve nga marrja e kërkesës së këtij institucioni. Nëse përgjigjja është pozitive, institucioni kompetent paraqet, në rast nevoje, kohëzgjatjen maksimale të dhënies të të ardhurave në natyrë, sikurse parashikohet nga legjislacioni që ai zbaton, dhe institucioni i vendqëndrimit vazhdon të japë të ardhurat në fjalë.
- 5 Në vend të vërtetimit apo dëshmisë së përmendur përkatësisht në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, punonjësi mund t'i paraqesë institucionit të vendqëndrimit vërtetimin e përmendur në paragrafin 1 të nenit 21 të Marrëveshjes. Në këtë rast, dispozitat e paragrafëve të mësipërm të këtij neni nuk janë të zbatueshme.
- 6 Dispozitat e paragrafit 6 të nenit 17 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

**Neni 21**

- 1 Për të përfituar të ardhura në natyrë në bazë të nënparagrafit a.i të paragrafit 1 të nenit 21 të Konventës, me përjashtim të rasteve kur përmendet hipoteza e parashtruar në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 20 të Marrëveshjes, i interesuari i paraqet institucionit të vendqëndrimit një vërtetim sipas të cilit ai ka të drejtë për këto të ardhura. Ky vërtetim, i lëshuar nga institucioni kompetent me kërkesë të të interesuarit, para se ai të dalë nga territori i Palës kontraktuese ku banon, paraqet konkretisht kohëzgjatjen maksimale të dhënies të të ardhurave në natyrë, sikurse parashikohet në legjislacionin e shtetit kompetent. Nëse i interesuari nuk e paraqet kërkesën në fjalë, institucion i vendqëndrimit i drejtohet institucionit kompetent për ta marrë atë.
- 2 Dispozitat e paragrafit 6 të nenit 17 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

**Neni 22**

- 1 Për të përfituar të ardhura në natyrë në bazë të nënparagrafit b.i të paragrafit 1 të nenit 21 të Konventës, i interesuari i paraqet institucionit të vendqëndrimit një vërtetim sipas të cilit ai është i autorizuar të ruajë të drejtën për përfitimin e këtyre të ardhurave. Ky vërtetim, i lëshuar nga institucioni kompetent me kërkesë të të interesuarit, para nisjes së tij, paraqet konkretisht, në rast nevoje, kohëzgjatjen maksimale gjatë së cilës të ardhurat në fjalë mund të vazhdojnë të shërbehen, sipas dispozitave ligjore të shtetit kompetent. Vërtetimi mund të lëshohet pas largimit të të interesuarit, me kërkesë të këtij të fundit, kur nuk është lëshuar më parë për arsye force madhore.
- 2 Dispozitat e paragrafit 6 të nenit 17 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.
- 3 Dispozitat e paragrafëve të mësipërm të këtij neni janë të zbatueshme *mutatis mutandis* në rastin e parashikuar në nënparagrafin c.i të paragrafit 1 të nenit 21 të Konventës.

**Neni 23**

Dispozitat e nenit 21 apo të nenit 22 të Marrëveshjes, sipas rastit, janë të zbatueshme *mutatis mutandis* për dhënien e të ardhurave në natyrë për anëtarët e familjes, përmendur në paragrafin 3 të nenit 21 të Konventës.

**Neni 24**

- 1 Për të përfituar të ardhura në para në bazë të nënparagrafit a.ii të paragrafit 1 të nenit 21 të Konventës, i interesuari i drejtohet institucionit të vendqëndrimit brenda tri ditësh nga fillimi i paaftësisë për punë, duke paraqitur, nëse legjislacioni që zbaton institucioni kompetent apo institucioni i vendqëndrimit e parashikojnë një gjë të tillë, një vërtetim paaftësie për punë lëshuar nga mjeku specialist. Ai bën të njohur nga ana tjetër adresën në vendin ku qëndron përkohësisht, si dhe emërtesën dhe adresën e institucionit kompetent.
- 2 Kur mjekët specialistë të vendit të qëndrimit nuk lëshojnë vërtetim paaftësie për punë, dispozitat e paragrafit 2 të nenit 19 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

- 3 Institucioni i vendqëndrimit i përcjell pa afat institucionit kompetent dokumentet e përmendura në paragrafët e mësipërm të këtij neni, duke përcaktuar konkretisht kohëzgjatjen e mundshme të paaftësisë për punë.
- 4 Nëse bëhet fjalë për persona të ndryshëm nga punonjësit e përmendur në nënparagrafin a.i të paragrafit 1 dhe në nënparagrafin a të paragrafit 2 të nenit 15 të Konventës, dhe nëse konstatohet nga ana mjekësore që gjendja e tyre shëndetësore nuk i pengon të rikthehen në territorin e Palës kontraktuese ku ata banojnë, institucioni i vendqëndrimit i vë menjëherë në dijeni për këtë me anë notifikimi, duke i drejtuar njëkohësisht kopje të këtij notifikimi institucionit kompetent.
- 5 Nga ana tjetër, dispozitat e paragrafëve 4 deri në 8 të nenit 19 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

#### Zbatimi i paragrafit 4 të nenit 22 të Konventës

##### Neni 25

- 1 Për të përfitur nga dispozitat e paragrafit 4 të nenit 22 të Konventës, i interesuari i paraqet institucionit kompetent një certifikatë lidhur me anëtarët e familjes që i banojnë në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent. Kjo certifikatë lëshohet nga institucioni i vendbanimit të anëtarëve të familjes.
- 2 Certifikata e përmendur në paragrafin e mësipërm është e vlefshme për një afat prej dymbëdhjetë muajsh nga data e lëshimit të saj. Ajo mund të ripërtëritet ; në këtë rast, vlefshmëria e saj fillon nga data kur ripërtëritet. I interesuari duhet t'i notifikojë menjëherë institucionit kompetent çdo ndryshim lidhur me përmbajtjen e certifikatës. Ndryshimi merr vlerë ditën kur ndodh fakti që përligj një veprim të tillë.
- 3 Në vend të certifikatës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, institucioni kompetent mund të kërkojë nga i interesuari të paraqesë dokumente të gjendjes civile lëshuar kohët e fundit lidhur me anëtarët e familjes që i banojnë në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, nëse të tilla dokumente lëshohen normalisht nga autoritetet e kësaj Pale.

#### Zbatimi i nenit 23 të Konventës

##### Neni 26

Dispozitat e nenit 17 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis* për dhënie të ardhurash në natyrë për të papunët dhe për anëtarët e familjeve të tyre që banojnë në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent.

#### Zbatimi i nenit 24 të Konventës

##### Neni 27

- 1 Për të përfitur të ardhura në natyrë në territorin e Palës kontraktuese ku banon, në bazë të paragrafit 2 të nenit 24 të Konventës, titullari i një pensioni apo rente regjistrohet, po ashtu edhe anëtarët e familjes së tij, pranë institucionit të vendbanimit, duke paraqitur një vërtetim që dëshmon se ai ka të drejtë për të ardhura në natyrë për vete dhe për anëtarët e familjes, në bazë të legjislacionit apo të një prej legjislacioneve sipas të cilave jepet një pension a rentë e caktuar.

- 2 Vërtetimi i përmendur në paragrafin e mësipërm lëshohet, me kërkesë të titullarit, nga institucioni apo nga njëri prej institucioneve dhënëse të pensionit a rentës apo, në rast nevoje, nga institucioni që vendos lidhur me të drejtën për të ardhura në natyrë, sapo titullari i plotëson kushtet për e çeljen e së drejtës për këto të ardhura. Nëse titullari nuk paraqet një vërtetim të tillë, institucioni i vendbanimit i drejtohet për ta marrë institucionit apo institucioneve dhënëse të pensionit a rentës apo, në rast nevoje, çdo institucioni tjetër në gjendje për të lëshuar vërtetimin në fjalë. Duke pritur lëshimin e këtij vërtetimi, institucioni i vendbanimit mund të bëjë regjistrim të përkohshëm për titullarin dhe anëtarët e familjes së tij mbështetur në dokumente vërtetuese të pranuar prej tij. Ky regjistrim bie ndesh me institucionin që përgjigjet për të ardhurat në natyrë vetëm kur ky i fundit ka lëshuar vërtetimin në fjalë.
- 3 Institucioni i vendbanimit njofton institucionin që lëshon vërtetimin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni për çdo regjistrim që ka bërë në përputhje me dispozitat e po këtij paragrafi.
- 4 Në çdo kërkesë për të ardhura në natyrë, institucioni i vendbanimit mund të kërkojë nga titullari dëshminë se ai gëzon vazhdimisht të drejtën për pension a rentë, nëpërmjet faturës apo mandat pagesës që i përgjigjet shlyerjes së fundit që i është bërë.
- 5 Titullari apo anëtarët e familjes duhet të njoftojnë institucionin e vendbanimit për çdo ndryshim të gjendjes së tyre që sjell modifikim të së drejtës për të ardhura në natyrë, konkretisht çdo pezullim apo heqje të pensionit a rentës dhe çdo transferim banimi që bëjnë. Institucionet në fjalë i bëjnë të ditur po ashtu institucionit të vendbanimit të titullarit çdo ndryshim për të cilin janë në dijeni.

#### **Neni 28**

- 1 Për të marrë të ardhura në natyrë në territorin e Palës kontraktuese ku banojnë, në bazë të paragrafit 4 të nenit 24 të Konventës, anëtarët e familjes të një titullari pensioni a rente regjistrohen pranë institucionit të vendbanimit të tyre, duke paraqitur, sipas legjislacionit që zbaton ky institucion, dokumente lëshuar në mënyrë të rregullt që përligjin përfitimin e të ardhurave të tilla destinuar për anëtarët e familjes të një titullari pensioni a rente, si dhe një vërtetim të ngjashëm me atë që përmendet në paragrafin 1 të nenit 27 të Marrëveshjes. Institucioni në fjalë njofton institucionin e vendbanimit të titullarit për çdo regjistrim që ka kryer në përputhje me dispozitat e këtij paragrafi.
- 2 Në kërkesën për të ardhura në natyrë, anëtarët e familjes i paraqesin institucionit të vendbanimit të tyre një vërtetim për të treguar që titullari ka të drejtë për të ardhura në natyrë për vete dhe për anëtarët e familjes ; ky vërtetim, i lëshuar nga institucioni i vendbanimit të titullarit, mbetet i vlefshëm për aq kohë sa institucioni i vendbanimit të anëtarëve të familjes nuk ka marrë notifikim për anulimin e tij.
- 3 Institucioni i vendbanimit të titullarit njofton institucionin e vendbanimit të anëtarëve të familjes për pezullimin apo heqjen e pensionit a rentës, si dhe për çdo transferim banimi që bën titullari. Institucioni i vendbanimit të anëtarëve të familjes mund t'i kërkojë në çdo kohë institucionit të vendbanimit të titullarit t'i paraqesë të gjitha të dhënat lidhur me të drejtat për të ardhura që ka ky i fundit.

- 4 Anëtarët e familjes e kanë për detyrë të njoftojnë institucionin e vendbanimit për çdo ndryshim të gjendjes së tyre që mund të modifikojë të drejtën për të ardhura në natyrë, konkretisht çdo transferim të banimit të tyre.

#### **Neni 29**

- 1 Për të përfiturar të ardhura në natyrë në bazë të paragrafit 6 të nenit 24 të Konventës, titullari i pensionit apo rentës i paraqet institucionit të vendqëndrimit një vërtetim lidhur me të drejtën që ai ka për këto të ardhura. Ky vërtetim, i lëshuar nga institucioni i vendbanimit të titullarit, para se ai ta lëshojë territorin e Palës kontraktuese ku banon, tregon konkretisht, në rast nevoje, kohëzgjatjen maksimale të dhënies të të ardhurave në natyrë, ashtu sikurse parashikohet në legjisllacionin e kësaj Pale. Nëse titullari nuk paraqet vërtetimin në fjalë, institucioni i vendqëndrimit i drejtohet institucionit të vendbanimit për ta marrë atë.
- 2 Dispozitat e paragrafit 6 të nenit 17 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*. Në këtë rast, institucioni i vendbanimit të titullarit konsiderohet si institucioni kompetent.
- 3 Dispozitat e paragrafit të mësipërm të këtij neni janë të zbatueshme *mutatis mutandis* për dhënien e të ardhurave në natyrë për anëtarët e familjes që parashikohen në paragrafin 6 të nenit 24 të Konventës.
- 4 Nëse për formalitetet e parashikuara në paragrafët e mësipërm të këtij neni nuk është bërë i mundur plotësimi i tyre gjatë qëndrimit të përkohshëm të të interesuarit në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, dispozitat e nenit 30 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

#### **Zbatimi i neneve 21 deri në 24 të Konventës**

##### **Neni 30**

Nëse për formalitetet e parashikuara në paragrafët 1, 2 dhe 5 të nenit 20 dhe në nenet 21 e 22 të Marrëveshjes nuk është bërë i mundur plotësimi i tyre gjatë qëndrimit të përkohshëm të të interesuarit në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, shpenzimet e nevojshme rimbursohen, me kërkesë të të interesuarit, nga institucioni kompetent sipas tarifave të rimbursimit që zbaton institucioni i vendqëndrimit. Ky institucion i jep institucionit kompetent, mbi bazë kërkesë, të dhënat e duhura për këto tarifa.

#### **Zbatimi i paragrafit 3 të nenit 25 të Konventës**

##### **Neni 31**

Për zbatimin e dispozitave të paragrafit 3 të nenit 25 të Konventës, institucioni i një Pale kontraktuese që shërben të ardhura i drejtohet, në u dashtë, institucionit të një Pale tjetër kontraktuese, për të marrë të dhëna lidhur me kohën gjatë së cilës ky institucion i fundit ka shërbyer të tilla të ardhura, për të njëjtin rast sëmundjeje apo barrë lindjeje.



**Kreu 2 – Invaliditet, pleqëri, vdekje (pensione)****Zbatimi i neneve 27 deri në 37 të Konventës****Paraqitje dhe udhëzim lidhur me kërkesat për të ardhura****Neni 32**

- 1 Për të përfituar të ardhura në bazë të neneve 28 deri në 34 të Konventës, i interesuari i drejton kërkesë institucionit të vendbanimit, sipas modaliteteve të parashikuara nga legjislacioni që zbaton ky institucion. Nëse kërkuesi apo personi që ka vdekur nuk kanë qenë objekt i këtij legjislacioni, institucioni i vendbanimit ia përcjell kërkesën institucionit të Palës kontraktuese në legjislacionin e së cilës kërkuesi apo personi i vdekur kanë qenë objekt për herë të fundit, duke përcaktuar datën në të cilën është paraqitur kërkesa. Kjo datë konsiderohet si data e paraqitjes së kërkesës pranë këtij institucioni të fundit.
- 2 Kur kërkuesi që banon në territorin e një Pale kontraktuese në legjislacionin e së cilës ai vetë apo personi që ka vdekur nuk kanë qenë objekt trajtimi, kërkesa në këtë rast mund t'i paraqitet institucionit të Palës kontraktuese në legjislacionin e së cilës ai vetë apo personi i vdekur kanë qenë objekt për herë të fundit.

**Neni 33**

Paraqitja e kërkesave të përmendura në nenin 32 të Marrëveshjes i nënshtrohet rregullave të mëposhtme :

- a kërkesa duhet shoqëruar nga dokumente të rregullta vërtetuese, hartuar sipas formulimeve të parashikuara
  - i qoftë nga legjislacioni i Palës kontraktuese në territorin e së cilës banon kërkuesi, për rastin e përmendur në paragrafin 1 të nenit 32 ;
  - ii qoftë nga legjislacioni i Palës kontraktuese, objekt i të cilit ka qenë kohët e fundit kërkuesi apo personi që ka vdekur, për rastin e përmendur në paragrafin 2 të nenit 32 ;
- b saktësia e të dhënave që paraqet kërkuesi duhet mbështetur nga dokumente zyrtare që shoqërojnë kërkesën, apo vërtetuar nëpërmjet organeve kompetente të Palës kontraktuese në territorin e së cilës ai banon ;
- c kërkuesi duhet të bëjë të ditur, për aq sa ka mundësi, qoftë institucionin apo institucionet e sigurimit për invaliditet, pleqëri apo rast vdekjeje (pensione) të çdo Pale kontraktuese, në legjislacionin e së cilës ai vetë apo personi i vdekur kanë qenë objekt trajtimi, qoftë punëdhënësin apo punëdhënësit nëpërmjet të cilëve ai vetë apo personi i vdekur ka qenë i punësuar në territorin e çdo Pale kontraktuese, duke paraqitur vërtetime pune në rast se i zotëron.

**Neni 34**

Për të përfituar nga dispozitat e paragrafit 3 të nenit 30 të Konventës, kërkuesi paraqet një vërtetim lidhur me anëtarët e familjes që banojnë në territorin e një Pale kontraktuese i ndryshëm nga territori ku ndodhet institucioni i ngarkuar për të shlyer të ardhurat. Ky vërtetim lëshohet, qoftë nga institucioni i vendbanimit të anëtarëve të familjes, kompetent në fushën e sëmundjes, qoftë nga një institucion tjetër i caktuar nga autoriteti kompetent i Palës kontraktuese në territorin e së cilës banojnë anëtarët e familjes. Dispozitat e paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 25 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

**Neni 35**

Për të përcaktuar shkallën e invaliditetit, institucioni i një Pale kontraktuese merr parasysh të gjitha të dhënat e karakterit mjekësor e administrativ të mbledhura nga institucioni i çdo Pale tjetër kontraktuese. Megjithatë, çdo institucion ruan mundësinë për ta kaluar kërkuenin në ekzaminim mjekësor nëpërmjet një mjeku që e për zgjedh vetë, duke marrë përsipër shpenzimet për një gjë të tillë.

**Neni 36**

- 1 Kërkesat për të ardhura përpunohen nga institucioni përkatës, së cilës ato i janë drejtuar apo përcjellë, sipas rastit, në përputhje me dispozitat e nenit 32 të Marrëveshjes. Ky institucion njihet me termin « institucioni udhëzues ».
- 2 Institucioni udhëzues notifikon menjëherë kërkesat për të ardhura tek të gjitha institucionet e lidhura me çështjen, me qëllim që këto kërkesa të mund të përpunohen prej tyre në të njëjtën kohë dhe pa afat.

**Neni 37**

- 1 Për përpunimin e kërkesave për të ardhura, institucioni udhëzues përdor një formular i cili përmban konkretisht pasqyrimin dhe rivlerësimin e periudhave të sigurimit apo të banimit që ka kryer vetë i interesuari apo personi që ka vdekur gjatë legjislacioneve të të gjitha Palëve kontraktuese në fjalë.
- 2 Përcjellja e këtij formulari tek institucioni i çdo Pale tjetër kontraktuese zëvendëson përcjelljen e shkresave për ligjëse.

**Neni 38**

- 1 Institucioni udhëzues pasqyron në formularin e përmendur në paragrafin 1 të nenit 37 të Marrëveshjes, periudhat e sigurimit apo të banimit të kryera nën legjislacionin që ai zbaton dhe i dërgon kopje të këtij formulari institucionit të sigurimit për invaliditet, pleqëri apo vdekje (pensione) të çdo Pale kontraktuese në legjislacionin e së cilës i interesuari apo personi i vdekur kanë qenë objekt trajtimi, duke bashkëngjitur, në rast nevojë, vërtetimet e punës paraqitur nga kërkuesi.
- 2 Nëse nuk ka veçse një institucion tjetër të lidhur me çështjen, ky institucion plotëson formularin që i është dërguar, në përputhje me dispozitat e paragrafit të mësipërm, duke shënuar periudhat e sigurimit apo të banimit të kryera nën legjislacionin që ai zbaton. Ky institucion përcakton më pas të drejtat që çelen sipas këtij legjislacioni, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 28 të Konventës, dhe përmend në këtë formular shumën teorike dhe shumën efektive të të ardhurës që ka llogaritur në përputhje me dispozitat e paragrafëve 2, 3, 4 apo 5 të nenit 29 të Konventës si dhe, në rast nevojë, shumën e të ardhurës që mund të pretendohet nga ana e kërkuetit, pa zbatim të neneve 28 deri në 33 të Konventës, dhe vetëm për periudhat e kryera nën legjislacionin që ai zbaton. Në formularin e përmendur, që i rikthehet institucionit udhëzues, jepen po ashtu rrugët dhe afatet e rekurseve.
- 3 Nëse ka dy a më shumë institucione të tjera të lidhura me çështjen, secili prej këtyre institucioneve plotëson formularin që i është dërguar, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, duke shënuar periudhat e sigurimit apo të banimit të kryera nën legjislacionin që ai zbaton dhe ia rikthen atë institucionit udhëzues. Ky institucion ia përcjell formularin e plotësuar në këtë mënyrë të gjitha institucioneve në fjalë; secili prej këtyre institucioneve përcakton të drejtat që çelen sipas

**Unofficial, unrevised translation**

legjislacionit që ai zbaton, duke mbajtur parasysh dispozitat e nenit 28 të Konventës, dhe përmend në këtë formular shumën teorike dhe shumën efektive të të ardhurës që ai ka llogaritur në përputhje me dispozitat e paragrafëve 2, 3, 4 apo 5 të nenit 29 të Konventës si dhe, në rast nevoje, shumën e të ardhurës që mund të pretendohet nga ana e kërkuesit, pa zbatim të neneve 28 deri në 33 të Konventës, dhe vetëm për periudhat e kryera nën legjislacionin që ai zbaton. Në formularin e përmendur, që i rikthehet institucionit udhëzues, jepen gjithashtu rrugët dhe afatet e rekurseve.

- 4 Kur institucioni udhëzues zotëron krejt të dhënat e përmendura në paragrafin 2 apo në paragrafin 3 të këtij neni, ai përcakton nga ana e vet të drejtat që çelen sipas legjislacionit që zbaton, duke mbajtur parasysh dispozitat e nenit 28 të Konventës dhe llogarit shumën teorike dhe shumën efektive të të ardhurës që duhet të japë, në përputhje me dispozitat e paragrafëve 2, 3, 4 apo 5 të nenit 29 të Konventës si dhe, në rast nevoje, shumën e të ardhurës që mund të pretendohet nga ana e kërkuesit, pa zbatim të neneve 28 deri në 33 të Konventës, dhe vetëm për periudhat e kryera nën legjislacionin që ai zbaton.
- 5 Sapo institucioni udhëzues konstaton, në bazë të të dhënave që ka marrë, siç parashikohet në paragrafët 2 apo 3 të këtij neni, se ka vend për zbatimin e dispozitave të paragrafëve 2 apo 3 të nenit 31, të paragrafëve 2, 4 apo 5 të nenit 32 apo të paragrafit 1 të nenit 34 të Konventës, ai vë në dijeni për një zbatim të tillë institucionet e tjera në fjalë.

**Neni 39**

- 1 Nëse institucioni udhëzues konstaton se kërkuesi ka të drejtë për të ardhura sipas legjislacionit që ai zbaton, pa qenë nevoja për të kërkuar periudha sigurimi apo banimi të kryera nën legjislacionet e Palëve të tjera kontraktuese, ku i interesuari apo personi i vdekur ka qenë objekt trajtimi, ky institucion i jep menjëherë këto të ardhura në mënyrë paraprake, në pritje të një vendimmarrjeje.
- 2 Në përputhje me dispozitat e paragrafit 5 të nenit 29 të Konventës, çdo institucion, i aftë për të llogaritur drejtpërdrejt të ardhurat apo elementët e të ardhurave që i detyrohet përfituesit, vepron menjëherë në dhënien e këtyre të ardhurave. Nëse bëhet fjalë për një institucion i ndryshëm nga institucioni udhëzues, që e shërben përfituesin drejtpërdrejt me këto të ardhura, ky institucion vë në dijeni menjëherë institucionin udhëzues dhe në zbatim të paragrafit 7 të këtij neni, rezervon shumën e mundshme të detyrimeve të prapambetura në dobi të çdo institucioni tjetër që mund të ketë derdhur shuma të tepërta.

- 3 Në rastin kur institucioni udhëzues e shërben të interesuarin me të ardhura në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, ai e zbrit, nëse është e nevojshme, shumën e këtyre të ardhurave nga shumata e të ardhurave që ka shërbyer çdo institucion tjetër në bazë të paragrafit të mësipërm, me t'u njohur me një veprim të tillë.
- 4 Nëse gjatë përpunimit të kërkesës, njëri nga institucionet e interesuara, i ndryshëm nga institucioni udhëzues, konstaton se kërkesi ka të drejtë për të ardhura në bazë të legjislacionit që ai zbaton, pa qenë nevoja të kërkojë periudhat e sigurimit apo të banimit të kryera nën legjislacionet e Palëve të tjera kontraktuese, ku i interesuari apo personi i vdekur kanë qenë objekt trajtimi, ai vë aty për aty në dijeni institucionin udhëzues, i cili e shërben në çast përfituesin me këto të ardhura në mënyrë paraprake, pa pritur vendimmarrjen, për llogari të institucionit të parë, dhe pa cënuar, në fund të fundit, dispozitat e paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni.
- 5 Në rastin kur institucioni udhëzues nuk shërben të ardhura në bazë të paragrafit 1 dhe të paragrafit 4 të këtij neni, ai shërben vetëm shumën e të ardhurës më të lartë, pa cënuar, në fund të fundit, dispozitat e paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni.
- 6 Në rastin kur institucioni udhëzues nuk shërben të ardhura në bazë të paragrafëve 1, 2 apo 4 të këtij neni, dhe në rastin kur mund të shkaktojë vonesë, ai i derdh të interesuarit një parapagesë të rikthyeshme, shumata e së cilës përcaktohet në përputhje me dispozitat e paragrafëve 1 deri në 4 të nenit 29 të Konventës.
- 7 Gjatë zgjidhjes përfundimtare të kërkesës për të ardhura, institucioni udhëzues dhe institucionet e tjera të interesuara bëjnë rregullimin e shumave që u përgjigjen të ardhurave që janë shërbyer para vendimmarrjes dhe të parapagesave që janë dhënë sipas dispozitave të paragrafëve 1, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni. Shumat e derdhura tepër nga institucionet në fjalë mund të mbahen nga shumata e prapambetura që nuk i janë shërbyer të interesuarit.

#### **Neni 40**

- 1 Në rastin e përmendur në paragrafin 2 të nenit 34 të Konventës, institucioni udhëzues llogarit dhe notifikon tek të gjitha institucionet përkatëse shumën përfundimtare të masës plotësuese që secili prej këtyre institucioneve duhet të japë.
- 2 Për zbatimin e dispozitave të nenit 34 të Konventës, konvertimi i shumave të shprehura në monedha të ndryshme kombëtare kryet me kursin zyrtar të këmbimit i vlefshëm ditën e parë të muajit gjatë të cilit është kryer veprimi i fundit likuidues i së ardhurës.

#### **Neni 41**

Për zbatimin e dispozitave të paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 33 të Konventës, dispozitat e neneve 38 dhe 40 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

**Neni 42**

- 1 Secili nga institucionet e lidhura me çështjen, i bën të ditur kërkuesit vendimin që ka marrë për sa i përket kërkesës për të ardhura paraqitur prej tij, me t'u trajtuar si përfundimtar një vendim i tillë dhe pasi është konsultuar paraprakisht me institucionin udhëzues, duke e vënë njëkohësisht edhe këtë të fundit në dijeni të po atij vendimi. Çdo vendim duhet të përmendë karakterin e pjesshëm të likuidimit që është bërë, si dhe të tregojë rrugët dhe afatet e rekurseve që parashikon legjislacioni përkatës.
- 2 Pas zgjidhjes përfundimtare të kërkesës për të ardhura, institucioni udhëzues bën një ripërmbledhje përfundimtare, duke i përcjellë kërkuesit të gjitha vendimet që kanë marrë institucionet e lidhura me çështjen.

**Neni 43**

Për të përshpejtuar likuidimin e të ardhurave, rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme :

- a kur një person paraprakisht objekt i legjislacionit të një a më shumë Palëve kontraktuese bëhet objekt i legjislacionit të një Pale tjetër kontraktuese, institucioni kompetent i kësaj Pale të fundit i drejtohet organizmit ndërlidhës të Palës apo të Palëve të tjera kontraktuese, për të marrë të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë konkretisht me institucionet që janë marrë me të interesuarin dhe, në rast nevoje, numrat regjistruar në të cilat ai ka figuruar ;
- b institucionet e lidhura me çështjen, për aq sa kanë mundësi, merren me kërkesën e të interesuarit apo të institucionit në të cilën ai bën pjesë, duke pasqyruar veprimtarinë e tij të shkuar deri një vit para datës në të cilën ai ka arritur moshën për plotësim pensioni pleqërie.

**Kontrolli administrativ e mjekësor****Neni 44**

- 1 Kur përfituesi :
  - a i të ardhurave për invaliditet,
  - b i të ardhurave për pleqëri të dhëna në rast paaftësie për punë,
  - c i të ardhurave për pleqëri të dhëna për të papunë të moshuar,
  - d i të ardhurave për pleqëri të dhëna në rast përfundimi të veprimtarisë profesionale,
  - e i të ardhurave për persona pasjetues të dhëna në rast invaliditeti apo paaftësie për punë,
  - f i të ardhurave që janë dhënë me kushtin që burimet e përfituesit të mos e tejkalojnë masën e parashkuar

është me qëndrim të përkohshëm apo me banim të zakonit në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, kontrolli administrativ apo mjekësor bëhet, me kërkesë të institucionit kompetent, nga institucioni i vendqëndrimit apo i vendbanimit, sipas modaliteteve të parashikuara nga legjislacioni që zbaton ky institucion i fundit. Megjithatë, institucioni kompetent ruan të drejtën për ta kaluar në ekzaminim mjekësor përfituesin tek një mjek që e përzgjedh vetë, duke marrë përsipër shpenzimet për këtë ekzaminim.

- 2 Nëse, pas kontrollit të përmendur në paragrafin paraprirës, konstatohet se përfituesi është i punësuar apo disponon burime që e tejkalojnë masën e parashkruar, institucioni i vendqëndrimit apo i vendbanimit duhet t'i paraqesë një raport institucionit kompetent që ka kërkuar kontrollin. Ky raport paraqet të dhënat e kërkuara nga institucioni kompetent, sipas rastit, dhe tregon konkretisht natyrën e punës së kryer, shumën e fitimeve apo burimet që dispononte i interesuari gjatë tremujorit të fundit, shpërblimin normal të marrë në të njëjtën zonë nga një punonjës i kategorisë profesionale ku përfshihej i interesuari në profesionin që ushtronte para se të bëhej invalid, gjatë një periudhe referuese të caktuar nga institucioni kompetent, si dhe, në rast nevojë, mendimin e një mjeku specialist për gjendjen shëndetësore të të interesuarit.

#### **Neni 45**

Kur, pas pezullimit të të ardhurave që përfitonte, i interesuari rifiton të drejtën për të ardhura, ndërkohë që banon në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, institucionet e lidhura me çështjen këmbëjnë të gjitha të dhënat e nevojshme për të rifilluar shërbimin e të ardhurave në fjalë.

#### **Pagesa e të ardhurave**

##### **Neni 46**

- 1 Nëse institucioni debitor i një Pale kontraktuese nuk ua shërben drejtpërdrejt të ardhurat që u takojnë përfituesve që banojnë në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, pagesa e këtyre të ardhurave bëhet me kërkesë të institucionit debitor, nëpërmjet organizmit ndërlidhës të kësaj Pale të fundit apo nëpërmjet institucionit të vendbanimit, sipas modaliteteve të parashikuara në nenet 47 deri në 51 të Marrëveshjes ; nëse institucioni debitor ua shërben të ardhurat drejtpërdrejt këtyre përfituesve, ai bën notifikimin e pagesës tek institucioni i vendbanimit.
- 2 Dispozitat e marrëveshjeve të mëparshme lidhur me pagesën e të ardhurave dhe të zbatueshme deri ditën që i paraprin hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, mbeten të zbatueshme për aq sa parashikohen në Shtojcën 5.

##### **Neni 47**

Institucioni debitor i të ardhurave i drejton, në dy kopje, organizmit ndërlidhës të Palës kontraktuese në territorin e së cilës banon përfituesi apo institucionit të vendbanimit, i përcaktuar me termin « organizmi pagues », një bordero për shumat e prapambetura, bordero e cila duhet t'i shkojë këtij organizmi jo më vonë se njëzet ditë para datës së mbylljes të të ardhurave.

**Neni 48**

- 1 Dhjetë ditë para datës së mbylljes të të ardhurave, institucioni debitor derdh, në monedhën e Palës kontraktuese në territorin e së cilës ndodhet i interesuari, shumën e nevojshme për pagesat e prapambetura të paraqitura në borderonë e parashikuar në nenin 47 të Marrëveshjes. Derdhja kryet pranë bankës kombëtare apo pranë një banke tjetër të kësaj Pale, në konton e hapur në emër të bankës kombëtare apo të një banke tjetër të Palës kontraktuese në territorin e së cilës ndodhet organizmi pagues, për llogari të këtij organizmi. Kjo derdhje është me efekt shlyes. Institucioni debitor i drejton njëkohësisht organizmit pagues një urdhër derdhjeje.
- 2 Banka për llogari të së cilës është kryer derdhja krediton organizmin pagues me kundërvlerën e derdhjes në monedhën e Palës kontraktuese në territorin e së cilës ndodhet ky organizëm.
- 3 Emri dhe qendra e bankave të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni përmenden në Shtojcën 6.

**Neni 49**

- 1 Shumat e prapambetura në borderonë e parashikuar në nenin 47 të Marrëveshjes i paguhen përfituesit nëpërmjet organizmit pagues, për llogari të institucionit debitor. Këto pagesa kryen sipas modaliteteve të parashikuara nga legjislacioni që zbaton organizmi pagues.
- 2 Shuma që i takon përfituesit konvertohet në monedhën e Palës kontraktuese në territorin e së cilës ai banon, me kursin që i është kredituar organizmit pagues shuma e derdhur në përputhje me dispozitat e nenit 48 të Marrëveshjes.
- 3 Kur organizmi pagues apo çdo organizëm tjetër i caktuar prej tij vihet në dijeni të një rrethane që përlligj pezullimin apo heqjen e të ardhurave, çdo pagesë ndalet. Po ashtu edhe kur përfituesi transferon vendbanimin e tij në territorin e një Pale kontraktuese i ndryshëm nga territori ku ndodhet organizmi pagues.
- 4 Organizmi pagues njofton institucionin debitor për çdo arsye mospagese dhe i paraqet, në rast nevojë datën kur ka ndodhur rrethana që përlligj këtë mospagesë.

**Neni 50**

- 1 Pagesat e përmendura në paragrafin 1 të nenit 49 të Marrëveshjes bëhen objekt verifikimi në mbarim të çdo periudhe pagimi, për të përcaktuar shumat efektivisht të derdhura tek përfituesit apo tek përfaqësuesit e tyre legalë apo mandatues, si dhe shumat e paderdhura.
- 2 Shuma totale, e përcaktuar me shifra dhe me gërma në monedhën e Palës kontraktuese në territorin e së cilës ndodhet institucioni debitor vërtetohet në përputhje me pagesat e kryera nga organizmi pagues, duke u nënshkruar nga përfaqësues të këtij organizmi.
- 3 Organizmi pagues bëhet garant për rregullsinë e pagesave të realizuara.

- 4 Diferenca midis shumave të derdhura nga institucioni debitor, të shprehura në monedhën e Palës kontraktuese në territorin e së cilës ai ndodhet, dhe vlerës, të shprehur në të njëjtën monedhë, të pagesave të përlygura nga organizmi pages futet në shumat që do derdhen më pas nga institucioni debitor po për këtë qëllim.

#### **Neni 51**

Shpenzimet lidhur me pagesën e të ardhurave, konkretisht shpenzimet postare e bankare, organizmi pages mund t'i mbajë nga shuma që u jep përfituesve, brenda kushteve të parashikuara nga legjislacioni që zbaton ky organizëm.

#### **Neni 52**

Kur përfituesi i të ardhurave që i merr në bazë të legjislacionit të një a më shumë Palëve kontraktuese transferon vendbanimin e tij nga territori i një Pale kontraktuese në atë të një Pale tjetër kontraktuese, ai duhet të notifikojë një transferim të tillë tek institucioni apo tek institucionet debitore për këto të ardhura dhe, në rast nevojë, tek organizmi pages.

### **Kreu 3 – Aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale**

#### **Dispozita të përgjithshme**

##### **Zbatimi i nenit 38 të Konventës**

#### **Neni 53**

- 1 Për të përfituar të ardhura në natyrë sipas nënparagrafit a të paragrafit 1 të nenit 38 të Konventës, punonjësi i paraqet institucionit të vendbanimit një vërtetim që dëshmon se ai ka të drejtë për këto të ardhura. Ky vërtetim lëshohet nga institucioni kompetent, duke pasur parasysh, në rast nevojë, të dhënat që jep punëdhënësi. Nga ana tjetër, nëse parashikohet në legjislacionin e shtetit kompetent, punonjësi i paraqet institucionit të vendbanimit një dëshmi ku është deklaruar aksidenti në punë apo sëmundja profesionale. Në rast se ai nuk paraqet dokumente të tilla, institucioni i vendbanimit i drejtohet institucionit kompetent për marrjen e tyre dhe në pritje, e shërben me të ardhura në natyrë për sëmundjen, për aq sa ka të drejtë për të tilla të ardhura.
- 2 Vërtetimi i parashikuar në paragrafin e mësipërm mbetet i vlefshëm për aq kohë sa institucioni i vendbanimit nuk ka marrë notifikim për anulimin e tij.
- 3 Nëse punonjësi ka cilësinë e punonjësit stinor, vërtetimi i parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni është i vlefshëm gjatë gjithë kohës së parashikuar për punën stinore, me kusht që, ndërkohë, institucioni kompetent të mos ketë bërë notifikim anulimi tek institucioni i vendbanimit.
- 4 Në çdo kërkesë për të ardhura në natyrë, punonjësi paraqet dokumentet përlygëse të marra normalisht për dhënie të ardhurash në natyrë, sipas legjislacionit të Palës kontraktuese në territorin e së cilës ai banon.
- 5 Në rast shtrimi në spital, institucioni i vendbanimit i notifikon institucionit kompetent, me t'u vënë në dijeni, datën e hyrjes në institucionin spitalor, kohëzgjatjen e mundshme të shtrimit dhe datën e daljes.
- 6 Punonjësi e ka për detyrë të njoftojë institucionin e vendbanimit për çdo ndryshim në gjendjen e tij që mund të modifikojë të drejtën për të ardhura në natyrë, konkretisht çdo braktisje apo ndërrim të punës a veprimtarisë profesionale, apo çdo transferim vendbanimi a vendqëndrimi të përkohshëm. Institucioni kompetent njofton gjithashtu institucionin e vendbanimit për përfundimin e të drejtave për të ardhura për punonjësin. Institucioni i vendbanimit mund t'i kërkojë në çdo kohë institucionit kompetent t'i paraqesë të gjitha të dhënat lidhur me të drejtat e punonjësit për të ardhura.



## Unofficial, unrevised translation

- 7 Nëse bëhet fjalë për punonjës kufitarë, mjekimet, fashimet, syzet, aparaturat e vogla mjekësore, analizat dhe ekzaminimet laboratorike mund të jepen apo të kryen vetëm në territorin e Palës kontraktuese ku ata janë regjistruar, sipas dispozitave ligjore të kësaj Pale.

**Neni 54**

- 1 Për të përfiturar të ardhura në para, veç rentave, në bazë të nënparagrafit b të paragrafit 1 të nenit 38 të Konventës, punonjësi i drejtohet institucionit të vendbanimit, brenda tre ditëve nga data e fillimit të paaftësisë për punë, duke i paraqitur një dokument që ka ndërrerë punën apo, nëse parashikohet nga legjislacioni që zbaton institucioni kompetent apo institucioni i vendbanimit, një vërtetim paaftësie për punë, lëshuar nga mjeku specialist. Ai duhet nga ana tjetër të paraqesë të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme në bazë të legjislacionit të shtetit kompetent, sipas natyrës të të ardhurave të kërkuara.
- 2 Kur mjekët specialistë të vendbanimit nuk lëshojnë vërtetim paaftësie për punë, punonjësi i drejtohet drejtpërdrejt institucionit të vendbanimit, brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni që është i zbatueshëm për të. Ky institucion organizon menjëherë konstatimin mjekësor lidhur me paaftësinë për punë me qëllim që të lëshohet vërtetimi i parashikuar në paragrafin e mësipërm.
- 3 Institucion i vendbanimit i përcjell pa afat institucionit kompetent dokumentet e parashikuara në paragrafët paraprirës të këtij neni, duke përcaktuar kohën e mundshme të paaftësisë për punë.
- 4 Me t'u krijuar mundësia, institucioni i vendbanimit kryen kontrollin mjekësor administrativ të punonjësit, sikur të bëhej fjalë për një punonjës të siguruar prej tij, dhe ia bën të ditur pa afat rezultatet institucionit kompetent, i cili ruan mundësinë për të ekzaminuar të interesuarin nga një mjek që e përzgjedh dhe e paguan vetë. Nëse ky institucion i fundit vendos të kundërshtojë të ardhurat sepse nuk janë respektuar rregullat e kontrollit nga ana e punonjësit, ai ia notifikon këtë vendim punonjësit dhe i drejton njëkohësisht kopje vendimi institucionit të vendbanimit.
- 5 Mbarimi i paaftësisë për punë i notifikohet pa afat punonjësit nga institucioni i vendbanimit, i cili njofton menjëherë institucionin kompetent. Kur ky institucion vendos vetë që punonjësi është ribërë i aftë për punë, ai ia notifikon këtë vendim punonjësit dhe i drejton njëkohësisht kopje vendimi institucionit të vendbanimit.
- 6 Nëse, për të njëjtin rast janë përcaktuar dy data të ndryshme, përkatësisht nga institucioni i vendbanimit dhe nga institucioni kompetent, për mbarimin e paaftësisë për punë, ruhet atëherë data e përcaktuar nga institucioni kompetent.
- 7 Kur punonjësi rifillon punën, ai njofton për këtë institucionin kompetent, nëse legjislacioni që zbaton ky institucion e parashikon një veprim të tillë.
- 8 Institucioni kompetent e shërben punonjësin me të ardhura në para nëpërmjet tërë rrugëve të përshtatshme, konkretisht me mandatpostë ndërkombëtare, dhe njofton për këtë institucionin e vendbanimit. Nëse këto të ardhura shërbehen nga institucioni i vendbanimit për llogari të institucionit kompetent, institucioni kompetent njofton punonjësin për të drejtat e tij sipas modaliteteve të parashikuara nga legjislacioni që zbaton ky institucion, dhe i tregon në të njëjtën kohë institucionin që është ngarkuar për ta shërbyer me të ardhura të tilla. Njëkohësisht, i bën të njohur institucionit të vendbanimit shumën e të ardhurave, datat në të cilat ato duhen shërbyer dhe kohëzgjatjen maksimale të dhënies së tyre, ashtu siç parashikohet nga legjislacioni i shtetit kompetent. Konvertimi i shumës të të ardhurave për t'u shërbyer nga ana e këtij institucioni kryet në bazë të kursit zyrtar të këmbimit i vlefshëm ditën e parë të muajit gjatë të cilit jepen këto të ardhura.

**Zbatimi i nenit 40 të Konventës****Neni 55**

- 1 Për të përfiturar të ardhura në natyrë, punonjësi i përmendur në nënparagrafin a.i të paragrafit 1 apo në nënparagrafin a të paragrafit 2 të nenit 15 të Konventës, i paraqet institucionit të vendqëndrimit vërtetimin e parashikuar në paragrafin 1 të nenit 12 të Marrëveshjes. Kur punonjësi në fjalë ka

## Unofficial, unrevised translation

paraqitur këtë vërtetim, kuptohet që ai ka përmbushur kushtet për çeljen e së drejtës për të ardhura në natyrë.

- 2 Për të përfituar të ardhura në natyrë, punonjësi i përmendur në nënparagrafin b.i të paragrafit 1 të nenit 15 të Konventës, që ndodhet me punë në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, i paraqet sa më shpejt institucionit të vendqëndrimit një dëshmi të lëshuar nga punëdhënësi apo përfaqësuesi i tij gjatë dy muajve civilë të mëparshëm. Kjo dëshmi tregon konkretisht datën kur i interesuari ka filluar të punojë për llogari të punonjësit në fjalë, si dhe emërtesën dhe selinë e institucionit kompetent. Kur punonjësi ka paraqitur këtë dëshmi, kuptohet që ai i ka përmbushur kushtet për çeljen e së drejtës për të ardhura në natyrë. Nëse nuk është në gjendje t'i drejtohet institucionit të vendqëndrimit para trajtimit mjekësor, ai përsëri gëzon të drejtën për t'u trajtuar me të paraqitur dëshminë në fjalë, sikur të kish qenë i siguruar pranë këtij institucioni.
- 3 Institucioni i vendqëndrimit i drejtohet pa afat institucionit kompetent për të mësuar nëse punonjësi i përmendur në paragrafin 1 apo në paragrafin 2 të këtij neni, sipas rastit, i plotëson kushtet për çeljen e së drejtës për të ardhura në natyrë. Ai e ka për detyrë ta shërbejë punonjësin me këto të ardhura deri sa të marrë përgjigje nga institucioni kompetent dhe brenda një afati prej tridhjetë ditësh.
- 4 Institucioni kompetent i drejton përgjigjen e vet institucionit të vendqëndrimit brenda dhjetë ditëve nga data që merr kërkesën nga ky institucion. Nëse kjo përgjigje është pozitive, institucioni kompetent paraqet, në rast nevojë, kohëzgjatjen maksimale të dhënies të të ardhurave në natyrë, sikurse parashikohet nga legjislacioni që ai zbaton, dhe në këtë mënyrë institucioni i vendqëndrimit vazhdon ta shërbejë punonjësin me të tilla të ardhura.
- 5 Në vend të vërtetimit apo dëshmisë të përmendura përkatësisht në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, punonjësi mund t'i paraqesë institucionit të vendqëndrimit vërtetimin e përmendur në paragrafin 1 të nenit 56 të Marrëveshjes. Në këtë rast, dispozitat e paragrafëve të mësipërm të këtij neni nuk janë të zbatueshme.
- 6 Dispozitat e paragrafit 5 të nenit 53 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

**Neni 56**

- 1 Për të përfiturar të ardhura në natyrë në bazë të nënparagrafit a.i të paragrafit 1 të nenit 40 të Konventës, me përjashtim të rasteve kur përmendet mundësia e parashikuar në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 55 të Marrëveshjes, punonjësi i paraqet institucionit të vendqëndrimit një vërtetim që dëshmon se ai ka të drejtë për të ardhura të tilla. Ky vërtetim, i lëshuar nga institucioni kompetent me kërkesë të punonjësit, para se ai të lërë territorin e Palës kontraktuese ku banon, tregon konkretisht, në rast nevoje, kohëzgjatjen maksimale të dhënies të të ardhurave në natyrë, sikurse parashikohet nga legjislacioni i shtetit kompetent. Nëse punonjësi nuk paraqet një vërtetim të tillë, institucioni i vendqëndrimit i drejtohet institucionit kompetent për marrjen e tij.
- 2 Dispozitat e paragrafit 5 të nenit 53 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

**Neni 57**

- 1 Për të përfiturar të ardhura në natyrë në bazë të nënparagrafit b.i të paragrafit 1 të nenit 40 të Konventës, punonjësi i paraqet institucionit të vendbanimit një vërtetim që dëshmon se ai është i autorizuar për të ruajtur përfitimin e këtyre të ardhurave. Ky vërtetim, i lëshuar nga institucioni kompetent, tregon konkretisht, në rast nevoje, kohëzgjatjen maksimale gjatë së cilës mund të shërbehen ende të ardhurat në fjalë, sipas dispozitave të legjislacionit të shtetit kompetent. Institucioni kompetent i drejton kopje të këtij vërtetimi organizmit të përcaktuar nga autoriteti kompetent i Palës kontraktuese në territorin e së cilës i interesuari është kthyer apo ka transferuar banimin e tij. Vërtetimi mund të lëshohet pas nisjes së punonjësit, me kërkesë të këtij të fundit, kur nuk ka mundur ta marrë më parë për arsye force madhore.
- 2 Dispozitat e paragrafit 5 të nenit 53 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.
- 3 Dispozitat e paragrafëve të mësipërm të këtij neni janë të zbatueshme *mutatis mutandis* për rastin e parashikuar në nënparagrafin c.i të paragrafit 1 të nenit 40 të Konventës.

**Neni 58**

- 1 Për të përfiturar të ardhura në para, veç rentave, në bazë të nënparagrafit a.ii të paragrafit 1 të nenit 40 të Konventës, punonjësi i drejtohet institucionit të vendqëndrimit brenda tri ditëve nga fillimi i paaftësisë për punë, duke paraqitur, nëse parashikohet nga legjislacioni që zbaton institucioni kompetent apo institucioni i vendqëndrimit, një vërtetim paaftësie për punë lëshuar nga mjeku specialist. Ai jep, nga ana tjetër, adresën e tij në vendin ku banon përkohësisht, si dhe emërtesën dhe adresën e institucionit kompetent.
- 2 Kur mjekët specialistë të vendit të qëndrimit të përkohshëm nuk lëshojnë vërtetim paaftësie për punë, dispozitat e paragrafit 2 të nenit 54 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.
- 3 Institucioni i vendqëndrimit i përcjell, pa afat, institucionit kompetent dokumentet e parashikuara në paragrafët paraprirës të këtij neni, duke përcaktuar konkretisht kohëzgjatjen e mundshme të paaftësisë për punë.

- 4 Nëse bëhet fjalë për punonjës të ndryshëm nga ata që përmenden në nënparagrafin a.i të paragrafit 1 dhe në nënparagrafin a të paragrafit 2 të nenit 15 të Konventës dhe nëse nga ana mjekësore konstatohet që gjendja e tyre shëndetësore nuk i pengon të kthehen në territorin e Palës kontraktuese ku banojnë, institucioni i vendqëndrimit i vë në dijeni për këtë menjëherë me anë notifikimi dhe i drejton kopje të këtij notifikimi institucionit kompetent.
- 5 Nga ana tjetër, dispozitat e paragrafëve 4 deri në 8 të nenit 54 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

#### Zbatime të neneve 38 deri në 40 të Konventës

##### Neni 59

- 1 Kur aksidenti në punë apo sëmundja profesionale kanë ndodhur në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, deklarimi duhet të bëhet në përputhje me dispozitat e legjislationit të shtetit kompetent, pa cënuar nga ana tjetër dispozitat ligjore në fuqi në territorin e Palës kontraktuese ku kanë ndodhur aksidenti apo sëmundja, zbatimi i të cilave mbetet i nevojshëm në një rast të tillë. Ky deklarim i drejtohet institucionit kompetent dhe një kopje e tij i paraqitet, në rast nevojë, institucionit të vendbanimit.
- 2 Institucioni i Palës kontraktuese në territorin e së cilës kanë ndodhur aksidenti në punë apo sëmundja profesionale i përcjell në dy kopje institucionit kompetent certifikatat mjekësore të lëshuara në këtë territor dhe, me kërkesë të këtij institucioni të fundit, të gjitha të dhënat e nevojshme.
- 3 Certifikata që konstaton shërimin e viktimës apo shëndoshjen e gjendjes së tij duhet, në rast nevojë, të përshkruaj në mënyrë të saktë gjendjen e viktimës dhe të përmbajë të dhëna për pasojat përfundimtare të aksidentit në punë apo të sëmundjes profesionale. Dëshmipërblimet shoqërore paguhen nga institucioni i vendbanimit apo institucioni i vendqëndrimit, sipas rastit, në bazë të tarifës që zbaton ky institucion dhe në ngarkim të institucionit kompetent.
- 4 Institucioni kompetent i notifikon institucionit të vendbanimit apo institucionit të vendqëndrimit, sipas rastit, vendimin që cakton datën e shërimit apo të shëndoshjes si dhe, në rast nevojë, vendimin lidhur me dhënien e një rente.

##### Neni 60

- 1 Kur institucioni që ka lidhje me çështjen kundërshton që, në rastin e parashikuar në paragrafin 1 të nenit 38 apo në paragrafin 1 të nenit 40 të Konventës, legjislationi lidhur me aksidentet në punë apo sëmundjet profesionale gjen zbatim, ai njofton menjëherë institucionin e vendbanimit apo institucionin e vendqëndrimit që ka dhënë të ardhura në natyrë, të cilat, në këtë rast, konsiderohen si të dhëna në bazë të kategorisë së sëmundjes dhe vazhdojnë të jepen po mbi këtë bazë, për aq sa i interesuari ka të drejtë për të tilla të ardhura.

- 2 Kur një vendim pason këtë kundërshtim, institucioni në fjalë vë në dijeni menjëherë institucionin e vendbanimit apo institucionin e vendqëndrimit që ka dhënë të ardhura në natyrë. Nëse nuk bëhet fjalë për një aksident në punë apo për një sëmundje profesionale, ky institucion vazhdon të shërbejë të ardhurat në natyrë për sëmundje, për aq sa i interesuari ka të drejtë për të tilla të ardhura. Në të kundërt, nëse bëhet fjalë për një aksident në punë apo për sëmundje profesionale, të ardhurat që ka përfituar punonjësi në bazë të gjendjes së sëmundjes konsiderohen si të ardhura për aksident në punë apo për sëmundje profesionale.

#### **Zbatimi i paragrafit 4 të nenit 43 të Konventës**

##### **Neni 61**

- 1 Për të vlerësuar shkallën e paaftësisë kur ndodh aksidenti në punë apo sëmundja profesionale, në rastin e përmendur në paragrafin 4 të nenit 43 të Konventës, punonjësi i paraqet institucionit kompetent të Palës kontraktuese, në legjislacionin e së cilës ai është objekt trajtimi, të gjitha të dhënat lidhur me aksidentet në punë apo sëmundjet profesionale, viktimë e të cilave ai ka qenë më parë, ndërkohë që i nënshtrohej legjislacionit të çdo Pale tjetër kontraktuese, cilado që të ketë qenë shkalla e paaftësisë e shkaktuar në këto raste të mëparshme të aksidentit në punë apo të sëmundjes profesionale.
- 2 Institucioni kompetent mund t'i drejtohet çdo institucioni tjetër që ka qenë kompetent më parë, për marrjen e të dhënave që i nevojiten.

#### **Zbatimi i paragrafit 2 të nenit 44 të Konventës**

##### **Neni 62**

Për zbatimin e dispozitave të paragrafit 2 të nenit 44 të Konventës, institucioni i Palës kontraktuese i caktuar për dhënien e të ardhurave mund t'i kërkojë, për aq sa e ka të nevojshme, institucionit të një Pale tjetër kontraktuese, t'i paraqesë të dhëna lidhur me kohën gjatë së cilës ky institucion ka paguar të ardhura për të njëjtin rast aksidenti në punë apo sëmundjeje profesionale.

#### **Zbatimi i paragrafit 3 të nenit 45 të Konventës**

##### **Neni 63**

Për të përfituar nga dispozitat e paragrafit 3 të nenit 45 të Konventës, kërkuesi i paraqet institucionit kompetent një certifikatë lidhur me anëtarët e familjes së tij që banojnë në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent. Kjo certifikatë lëshohet qoftë nga institucioni i vendbanimit të këtyre anëtarëve të familjes, kompetent në fushën e sëmundjes, qoftë nga një institucion tjetër i përcaktuar nga autoriteti kompetent i Palës kontraktuese në territorin e së cilës banojnë këta anëtarë të familjes. Nga ana tjetër, dispozitat e paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 25 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

**Zbatimi i nenit 46 të Konventës****Neni 64**

- 1 Në rastin e përmendur në paragrafin 1 të nenit 46 të Konventës, deklarimi për sëmundje profesionale i drejtohet qoftë institucionit kompetent në fushën e sëmundjes profesionale të Palës kontraktuese nën legjislacionin e së cilës viktimja ka ushtruar së fundi një veprimtari në gjendje për të shkaktuar sëmundjen e shqyrtuar, qoftë institucionit të vendbanimit, i cili ia përcjell këtë deklarim institucionit të parë.
- 2 Nëse institucioni të cilit i është drejtuar deklarimi vëren se një veprimtari në gjendje për të shkaktuar sëmundjen profesionale të shqyrtuar është ushtruar së fundi nën legjislacionin e një Pale kontraktuese, ai ia përcjell deklarimin dhe dokumentet shoqëruese institucionit korrespondues të kësaj Pale, duke vënë njëkohësisht në dijeni të interesuarin.
- 3 Kur institucioni i Palës kontraktuese, nën legjislacionin e së cilës viktimja ka ushtruar së fundi një veprimtari në gjendje për të shkaktuar sëmundjen profesionale të shqyrtuar, konstaton se viktimja apo pasjetuesit e saj nuk i plotësojnë kushtet e këtij legjislacioni, në bazë të dispozitave të paragrafëve 2, 3 dhe 4 të nenit 46 të Konventës, institucioni në fjalë :
  - a i përcjell pa afat, institucionit të Palës kontraktuese nën legjislacionin e së cilës viktimja ka ushtruar më parë një veprimtari në gjendje për të shkaktuar sëmundjen e shqyrtuar, deklarimin dhe tërë dokumentet që e shoqërojnë, duke përfshirë edhe konstatimet dhe raportet e ekspertizave mjekësore që ka kryer institucioni i parë, si dhe kopje të vendimit të përmendur në nënparagrafin e mëposhtëm ;
  - b i notifikon në të njëjtën kohë të interesuarit vendimin e tij, duke parashtruar konkretisht arsyet që motivojnë kundërshtimin e të ardhurave, rrugët dhe afatet e rekurseve, si dhe datën në të cilën dosja i është përcjellë institucionit të përmendur në nënparagrafin e mësipërm.
- 4 Në rast nevojë, ka vend për t'iu drejtuar, sipas së njëjtës procedurë, deri edhe institucionit korrespondues të Palës kontraktuese nën legjislacionin e së cilës viktimja ka ushtruar fillimisht një veprimtari në gjendje për të shkaktuar sëmundjen profesionale të shqyrtuar.

**Neni 65**

- 1 Në rastin e ndjekjes së një rekursi kundër një vendimi mospranimi të marrë nga institucioni i njëres prej Palëve kontraktuese, nën legjislacionin e të cilave viktimja ka ushtruar një veprimtari në gjendje të shkaktojë sëmundjen profesionale të shqyrtuar, ky institucion e ka për detyrë të vërë në dijeni institucionin të cilit i është paraqitur eventualisht deklarimi, sipas procedurës së parashikuar në paragrafin 3 të nenit 64 të Marrëveshjes, si dhe ta njoftojë më pas për vendimin përfundimtar që do merret.
- 2 Nëse e drejta për të ardhura është çelur në bazë të legjislacionit që zbaton institucioni të cilit i është paraqitur deklarimi sipas procedurës së parashikuar në paragrafin 3 të nenit 64 të Marrëveshjes, duke pasur parasysh dispozitat e paragrafëve 2, 3 dhe 4 të nenit 46 të Konventës, ky institucion i jep të interesuarit paradhënie, shuma e të cilave caktohet pasi konsultohet institucioni ndaj të cilit ka nisur rekursi kundër vendimit të tij. Nëse, pas rekursit, ky institucion duhet të paguajë të ardhurat, ai e rimbursos institucionin e mëparshëm për shumën e paradhënies që ka dhënë dhe mban një shumë korresponduese nga të ardhurat që i detyrohet personit përkatës.

**Zbatimi i nenit 47 të Konventës****Neni 66**

Në rastin e përmendur në nenin 47 të Konventës, punonjësi e ka për detyrë t'i paraqesë institucionit të Palës kontraktuese që vlerëson të drejtat e tij tërë të dhënat lidhur me të ardhurat që ka përfituar më

parë për sëmundje profesionale të shqyrtuar dhe me veprimtaritë profesionale që ka ushtruar nga koha e dhënies së këtyre të ardhurave. Ky institucion mund t'i drejtohet çdo institucioni tjetër që ka qenë kompetent më parë për vjeljen e të dhënave që i quan të domosdoshme.

### **Paraqitja dhe trajtimi i kërkesave për renta**

#### **Neni 67**

- 1 Kur një punonjës apo pasjetuesit e tij që banojnë në territorin e një Pale kontraktuese kërkojnë përfitimin e një rente a të ardhure për të plotësuar një rentë në bazë të legjislacionit të një Pale tjetër kontraktuese, ata e drejtojnë kërkesën e tyre qoftë në institucionin kompetent, qoftë në institucionin e vendbanimit, i cili ia përcjell institucionit kompetent. Paraqitja e kërkesës i nënshtrohet rregullave të mëposhtme :
  - a kërkesa duhet të shoqërohet nga vërtetimet e duhura, hartuar sipas formulimeve që parashikon legjislacioni i shtetit kompetent ;
  - b saktësia e të dhënave që paraqet kërkuesi duhet mbështetur me dokumente zyrtare që shoqërojnë kërkesën, apo vërtetuar nga organet kompetente të Palës kontraktuese në territorin e së cilës ai banon.
- 2 Institucioni kompetent i notifikon vendimin e tij kërkuetit drejtpërdrejt apo nëpërmjet organizmit ndërlidhës të shtetit kompetent ; ai i dërgon kopje të këtij notifikimi organizmit ndërlidhës të Palës kontraktuese në territorin e së cilës banon kërkuesi.

### **Kontrolli administrativ e mjekësor**

#### **Neni 68**

Kur titullari i një rente banon apo qëndron përkohësisht në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, kontrolli administrativ e mjekësor, si dhe ekzaminimet mjekësore të nevojshme për rishikimin e rentave kryen, me kërkesë të institucionit kompetent, nga institucioni i vendbanimit apo i vendqëndrimit, sipas modaliteteve të parashikuara nga legjislacioni që zbaton institucioni i fundit. Megjithatë, institucioni kompetent ruan të drejtën për të bërë ekzaminim të përfituesit nëpërmjet një mjeku të cilin e zgjedh dhe e paguan vetë.

### **Pagesa e rentave**

#### **Neni 69**

Pagesa e rentave që institucioni i një Pale kontraktuese i detyrohet titullarëve banues në territorin e një Pale tjetër kontraktuese kryet në përputhje me dispozitat e parashikuara nga nenet 46 deri në 51 të Marrëveshjes.

### **Kreu 4 – Vdekjet (pagesa)**

#### **Zbatimi i neneve 49 dhe 50 të Konventës**

#### **Neni 70**

Kur një person që banon në territorin e një Pale kontraktuese kërkon përfitimin e një pagese për rast vdekjeje në bazë të legjislacionit të një Pale tjetër kontraktuese, ai i drejton kërkesën e tij qoftë institucionit kompetent, qoftë institucionit të vendbanimit, me dokumentet e nevojshme për ligjëse në bazë të legjislacionit që zbaton institucioni kompetent. Saktësia e të dhënave që paraqet kërkuesi duhet mbështetur nga dokumente zyrtare që shoqërojnë kërkesën apo vërtetuar nga organe kompetente të Palës kontraktuese në territorin e së cilës ai banon.

#### **Neni 71**

- 1 Për të përfituar nga dispozitat e nenit 49 të Konventës, i interesuari i paraqet institucionit kompetent një vërtetim ku tregohen periudhat e sigurimit apo të banimit të kryera nën legjislacionin e Palës kontraktuese, objekt i të cilit ka qenë së fundi personi që çel të drejtën për pagesë në rast vdekjeje.
- 2 Vërtetimi i përmendur në paragrafin e mësipërm lëshohet me kërkesë të të interesuarit nga institucioni kompetent në fushën e sëmundjes apo të pleqërisë, sipas rastit, të Palës kontraktuese, në legjislacionin e së cilës personi që çel të drejtën për pagesë në rast vdekjeje ka qenë së fundi objekt trajtimi. Nëse i interesuari nuk paraqet vërtetimin në fjalë, institucioni kompetent i drejtohet këtij institucioni të fundit për ta marrë atë.
- 3 Nëse është e nevojshme të mbahen parasysh periudhat e sigurimit apo të banimit të kryera më parë nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, për përmbushjen e kushteve që parashikon legjislacioni i shtetit kompetent, dispozitat e paragrafëve të mësipërm të këtij neni janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

## Kreu 5 – Papunësia

### Zbatimi i nenit 51 të Konventës

#### Neni 72

- 1 Për të përfituar nga dispozitat e paragrafit 1 apo të paragrafit 2 të nenit 51 të Konventës, i interesuari i paraqet institucionit kompetent një vërtetim ku përmenden periudhat e sigurimit, punësimit, apo të veprimtarisë profesionale të kryera nën legjislacionin e Palës kontraktuese në të cilën ai ka qenë më parë, për herë të fundit objekt trajtimi dhe jep tërë të dhënat plotësuese që kërkon legjislacioni i zbatueshëm nga ky institucion.
- 2 Vërtetimi i përmendur në paragrafin e mësipërm lëshohet, me kërkesë të të interesuarit, qoftë nga institucioni kompetent në fushën e papunësisë të Palës kontraktuese në legjislacionin e së cilës ai ka qenë më parë, për herë të fundit objekt trajtimi, qoftë nga një tjetër institucion i caktuar nga autoriteti kompetent i kësaj Pale. Nëse i interesuari nuk paraqet vërtetimin në fjalë, institucioni kompetent i drejtohet njërit prej këtyre institucioneve për ta marrë atë, por mund të ndodhë gjithashtu që institucioni kompetent në fushën e sëmundjes t'i përcjellë një kopje të vërtetimit të parashikuar në përputhje me paragrafin 1 të nenit 16 të Marrëveshjes.
- 3 Nëse është e nevojshme të mbahen parasysh periudhat e sigurimit, punësimit apo të veprimtarisë profesionale të kryera më parë nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, për përmbushjen e kushteve që parashikon legjislacioni i shtetit kompetent, dispozitat e paragrafëve të mësipërm të këtij neni janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

### Zbatimi i nenit 52 të Konventës

#### Neni 73

- 1 Për të përfituar nga dispozitat e nenit 52 të Konventës, i interesuari i paraqet institucionit të vendbanimit të tij të ri një vërtetim që dëshmon se ai i plotëson kushtet e kërkuara nga legjislacioni i shtetit kompetent për njohjen e së drejtës për të ardhura, duke pasur parasysh plotësimin e periudhave të sigurimit, punësimit, veprimtarisë profesionale apo të banimit, si dhe paraqet tërë të dhënat plotësuese të kërkuara nga legjislacioni që zbaton ky institucion.
- 2 Vërtetimi i përmendur në paragrafin e mësipërm lëshohet nga institucioni kompetent me kërkesë të të interesuarit para se të bëjë transferimin e vendbanimit. Ky institucion i drejton një kopje institucionit të caktuar nga autoriteti kompetent i Palës kontraktuese në territorin e së cilës i interesuari transferon banesën e tij. Nëse i interesuari nuk paraqet vërtetimin në fjalë apo nëse institucioni i vendbanimit të ri nuk ka marrë kopje të këtij vërtetimi, ky institucion i drejtohet institucionit kompetent për ta marrë atë.



**Zbatimi i nenit 53 të Konventës****Neni 74**

- 1 Në rastet e përmendura në nënparagrafin a.ii dhe në nënparagrafin b.ii të paragrafit 1 të nenit 53 të Konventës, institucioni i vendbanimit konsiderohet si institucioni kompetent për zbatimin e dispozitave të nenit 72 të Marrëveshjes.
- 2 Në rastin e përmendur në nënparagrafin b.iii të paragrafit 1 të nenit 53 të Konventës, dispozitat e nenit 73 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.
- 3 Për zbatimin e dispozitave të paragrafit 2 të nenit 53 të Konventës, institucioni i vendbanimit i kërkon institucionit kompetent tërë të dhënat lidhur me të drejtat e të interesuarit ndaj këtij institucioni të fundit.

**Zbatimi i nenit 54 të Konventës****Neni 75**

Për zbatimin e dispozitave të nenit 54 të Konventës, institucioni kompetent paraqet, në rast nevojë, në vërtetimin e përmendur në paragrafin 1 të nenit 73 të Marrëveshjes, kohën gjatë së cilës ka dhënë të ardhura pas konstatimit të fundit të së drejtës për të ardhura.

**Zbatimi i nenit 55 të Konventës****Neni 76**

Për llogaritjen e të ardhurave për shlyerje nga ana e një institucioni që përmendet në paragrafin 1 të nenit 55 të Konventës, në rastin kur i interesuari nuk ka ushtruar punë për herë të fundit të paktën katër javë në territorin e një Pale kontraktuese ku ndodhet ky institucion, ai paraqet një vërtetim ku tregohet lloji i punës së fundit që ka ushtruar në territorin e një Pale tjetër kontraktuese ku ka punuar të paktën katër javë, si dhe dega ekonomike në të cilën është ushtruar kjo punë. Nëse punonjësi nuk paraqet këtë vërtetim, institucioni në fjalë i drejtohet, për marrjen e tij, qoftë institucionit kompetent në fushën e papunësisë të kësaj Pale të fundit, qoftë një institucioni tjetër të cakuar nga autoriteti kompetent i kësaj Pale.

**Neni 77**

Për të përfutuar nga dispozitat e paragrafit 2 të nenit 55 të Konventës, i interesuari i paraqet institucionit kompetent një vërtetim lidhur me anëtarët e familjes së tij që banojnë në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent. Ky vërtetim lëshohet qoftë nga institucioni i vendbanimit të këtyre anëtarëve të familjes, kompetent në fushën e sëmundjes, qoftë nga një institucion tjetër i caktuar nga autoriteti kompetent i Palës kontraktuese në territorin e së cilës banojnë këta anëtarë të familjes. Nga ana tjetër, dispozitat e paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 25 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

**Kreu 6 – Të ardhurat për familje****Zbatimi i nenit 57 të Konventës****Neni 78**

- 1 Për të përfutuar nga dispozitat e nenit 57 të Konventës, i interesuari i paraqet institucionit kompetent një vërtetim ku përmenden periudhat e punësimit, veprimtarisë profesionale a të banimit të kryera nën legjislacionin e Palës kontraktuese, objekt i të cilit ai ka qenë më parë, për herë të fundit, si dhe jep tërë të dhënat plotësuese të kërkuara nga legjislacioni që zbaton ky institucion i fundit.
- 2 Vërtetimi i përmendur në paragrafin e mësipërm lëshohet, me kërkesë të të interesuarit, qoftë nga institucioni kompetent në fushën e të ardhurave për familje të Palës kontraktuese në legjislacionin e së cilës ai ka qenë objekt trajtimi më parë, për herë të fundit, qoftë nga një institucion tjetër i caktuar nga autoriteti kompetent i kësaj Pale. Nëse i interesuari nuk paraqet vërtetimin në fjalë, institucioni kompetent i drejtohet njërit prej këtyre institucioneve për ta marrë atë, por mund të ndodhë gjithashtu që institucioni kompetent në fushën e sëmundjes t'i transmetojë një kopje të vërtetimit të parashikuar në përputhje me paragrafin 1 të nenit 16 të Marrëveshjes.
- 3 Nëse është e nevojshme të mbahen parasysh periudhat e punësimit, të veprimtarisë profesionale a të banimit të kryera më parë nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, për përmbushjen e kushteve që parashikon legjislacioni i shtetit kompetent, dispozitat e paragrafëve të mësipërm të këtij neni janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

**Zbatimi i neneve 59 dhe 60 të Konventës****Neni 79**

- 1 Për të përfituar nga dispozitat e nenit 59 të Konventës, i interesuari i drejton një kërkesë institucionit kompetent, në rast nevoje, me ndërmjetësinë e punëdhënësit të tij.
- 2 Në rast zbatimi të paragrafit 3 të nenit 59 të Konventës, me qëllim që të arrihet krahasimi i parashikuar në paragrafin 4 të nenit në fjalë, institucioni kompetent merr të dhënat lidhur me shumën e pagesave familjare të parashikuara nga legjislacioni i Palës kontraktuese në territorin e së cilës banojnë apo janë rritur fëmijët nëpërmjet autoritetit kompetent nga i cili varet. Ky autoritet kompetent i drejtohet në mbarim të çdo tremujori autoritetit kompetent të Palës kontraktuese në fjalë për marrjen e këtyre të dhënave, të cilat duhen mbështetur mbi gjendjen e legjislacionit të zbatueshëm ditën e pesëmbëdhjetë të muajit të fundit të tremujorit të fundit të shqyrtuar dhe që përbëjnë bazat e vlefshme për likuidimin e këtyre pagesave për familje që lidhen me tremujorin që pason.
- 3 I interesuari paraqet, në mbështetje të kërkesës së tij, një certifikatë të gjendjes familjare të lëshuar nga autoritetet kompetente në fushën e gjendjes civile në territorin e Palës kontraktuese ku banojnë apo janë rritur fëmijët, nëse dokumente të tillë lëshohen normalisht nga këto autoritete, apo, në të kundërt, nga autoriteti kompetent i kësaj Pale. Kjo certifikatë e gjendjes familjare duhet ripërtërirë një herë në vit.
- 4 Nga ana tjetër, i interesuari jep, në rast nevoje, me kërkesë të institucionit kompetent, të dhënat që lejojnë të individualizojnë personin të cilit duhet t'i shërbehen pagesat për familje në territorin e Palës kontraktuese ku banojnë apo janë rritur fëmijët.
- 5 I interesuari e ka për detyrë të njoftojë institucionin kompetent, në rast nevoje nëpërmjet punëdhënësit të tij, për çdo ndryshim të gjendjes së fëmijëve të tij që mund të prekë të drejtën për pagesa për familje, konkretisht çdo transferim të vendbanimit të tyre dhe çdo ndryshim të numrit të fëmijëve për të cilët jepen pagesat për familje.
- 6 Dispozitat e paragrafëve 1, 3 dhe 5 të këtij neni janë të zbatueshme për rastin e parashikuar në paragrafin 5 të nenit 59 të Konventës.

**Neni 80**

- 1 Nëse i interesuari ka ushtruar një punë a një veprimtari profesionale apo nëse ka banuar gjatë një muaji apo një tremujori civil në territorin e dy Palëve kontraktuese, pagesat për familje për të cilat ai mund të pretendojë, në bazë të legjislacioneve të çdonjëres prej këtyre Palëve, korrespondojnë me numrin e pagesave të përditshme të dhëna në zbatim të legjislacionit të shqyrtuar. Nëse njëra apo tjetra nga këto dy legjislacione parashikon ose dhënien e pagesave mujore, ose dhënien e pagesave tremujore, pagesa bëhet në bazë të këtij legjislacioni, konkretisht qoftë një e njëzet e gjashta pjesë e shumës së pagesave mujore, qoftë një e shtatëdhjetë e teta pjesë e shumës së pagesave tremujore për çdo ditë pune, veprimtarie profesionale apo vendqëndrimi të kryer në territorin e Palës kontraktuese të shqyrtuar dhe për çdo ditë të trajtuar nga legjislacioni i kësaj Pale.

- 2 Nëse institucioni i një Pale kontraktuese ka shërbyer pagesa për familje për një muaj apo një pjesë muaji, ndërkohë që kjo detyrë i takonte institucionit të një Pale tjetër kontraktuese, pagesat e shërbyera pa të drejtë bëhen shkas për zbritje në kontot e këtyre institucioneve.

#### Zbatimi i nenit 61 të Konventës

##### Neni 81

- 1 Për të përfituar të ardhura për familje në territorin e Palës kontraktuese ku banojnë, anëtarët e familjes të parashikuar në paragrafin 1 të nenit 61 të Konventës regjistrohen pranë institucionit të vendbanimit të tyre, duke paraqitur dokumentet vërtetues normalisht të lëshuar për dhënie të ardhurash për familje, në bazë të legjislacionit që zbaton ky institucion, si dhe një vërtetim që dëshmon se i interesuari i plotëson kushtet e çeljes të së drejtës për të ardhura dhe që përmban, për këtë qëllim, të dhënat e mëposhtme :
  - a nëse legjislacioni i shtetit kompetent nuk e sheh çeljen e së drejtës për të ardhura të varur nga asnjë kusht punësimi apo veprimtarie profesionale, vërtetimi përmend vetëm faktin që i interesuari është objekt i legjislacionit të këtij shteti ;
  - b nëse legjislacioni i shtetit kompetent e sheh çeljen e së drejtës për të ardhura të varur nga një kohë e caktuar punësimi apo veprimtarie profesionale, vërtetimi dëshmon që ky kusht është i përmbushur ;
  - c nëse legjislacioni i shtetit kompetent parashikon se e drejta për të ardhura çelet për një kohëzgjatje që i përgjigjet kohës së periudhave të punësimit apo të veprimtarisë profesionale, vërtetimi dëshmon për kohën e punësimit apo të veprimtarisë profesionale të kryer gjatë periudhës së shqyrtuar.

Ky vërtetim lëshohet nga institucioni kompetent me kërkesë të të interesuarit, me t'i plotësuar kushtet e nevojshme. Nëse anëtarët e familjes nuk paraqesin vërtetimin në fjalë, institucioni i vendbanimit të tyre i drejtohet institucionit kompetent për ta marrë atë.
- 2 Vërtetimi i parashikuar në paragrafin paraprirës, në rastet e përmendura në nënparagrafët a dhe b, mbetet i vlefshëm për aq kohë sa institucioni i vendbanimit nuk ka marrë notifikim për anulimin e tij. Megjithatë, në rastin e përmendur në nënparagrafin c, ky vërtetim është i vlefshëm vetëm për një afat prej tre muajsh që pason datën e lëshimit të tij dhe duhet të ripërtërihet *ex officio* çdo tre muaj nga institucioni kompetent.
- 3 Nëse i interesuari ka cilësinë e punonjësit stinor, vërtetimi i parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni është i vlefshëm gjatë tërë kohës së parashikuar për punën stinore, mjaft që institucioni kompetent të mos ketë notifikuar ndërkohë anulimin e tij tek institucioni i vendbanimit.
- 4 Nëse legjislacioni i Palës kontraktuese në territorin e së cilës banojnë anëtarët e familjes parashikon dhënien e të ardhurave mujore apo tremujore, ndërkohë që legjislacioni i shtetit kompetent parashikon që e drejta për të ardhura çelet për një kohëzgjatje që i përgjigjet kohës së punësimit apo të veprimtarisë profesionale të kryer, të ardhurat jepen duke përpjestuar këtë kohëzgjatje me atë që parashikon legjislacioni i vendbanimit të anëtarëve të familjes.

- 5 Nëse legjislacioni i Palës kontraktuese në territorin e së cilës banojnë anëtarët e familjes parashikon dhënien e të ardhurave për një numër ditësh që i përgjigjen ditëve të kryera të punës apo të veprimtarisë profesionale, ndërkohë që legjislacioni i shtetit kompetent parashikon që e drejta për të ardhura çelet për një muaj apo për një tremujor të plotë, të ardhurat jepen për një muaj apo për një tremujor.
- 6 Në rastet e përmendura në paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni, kur periudhat e punësimit apo të veprimtarisë profesionale të plotësuara nën legjislacionin e shtetit kompetent shprehen në njësi të ndryshme nga ato që shërbejnë për llogaritjen e të ardhurave në bazë të legjislacionit të Palës kontraktuese në territorin e së cilës banojnë anëtarët e familjes, konvertimi kryet në përputhje me dispozitat e paragrafit 3 të nenit 15 të Marrëveshjes.
- 7 Institucioni kompetent njofton menjëherë institucionin e vendbanimit të anëtarëve të familjes për datën kur i interesuari përfundon të drejtën për të ardhura apo transferon banimin e tij nga territori i një Pale kontraktuese në territorin e një Pale tjetër kontraktuese. Institucioni i vendbanimit të anëtarëve të familjes mund t'i kërkojë në çdo kohë institucionit kompetent t'i paraqesë të gjitha të dhënat lidhur me të drejtat për të ardhura të të interesuarit.
- 8 Anëtarët e familjes e kanë për detyrë të njoftojnë institucionin e vendbanimit të tyre për çdo ndryshim të gjendjes së tyre që mund të modifikojë të drejtën për të ardhura, konkretisht çdo transferim banese.

#### **Neni 82**

Nëse anëtarët e familjes e transferojnë banimin e tyre nga territori i një Pale kontraktuese në atë të një Pale tjetër kontraktuese gjatë një muaji apo një tremujori civil, të ardhurat për familje që u jepen sipas legjislacionit të secilës prej këtyre Palëve i përgjigjen numrit të të ardhurave për ditë pune në zbatim të legjislacionit të shqyrtuar. Nëse njëri apo tjetri legjislacion parashikon qoftë dhënien e të ardhurave mujore, qoftë dhënien e të ardhurave tremujore, këto të ardhura jepen në raport me kohën e banimit të të interesuarve në territorin e Palës në fjalë gjatë muajit apo tremujorit në shqyrtim.

#### **Zbatimi i nenit 62 të Konventës**

#### **Neni 83**

- 1 Për të përfitur të ardhura për familje në territorin e Palës kontraktuese ku banojnë, anëtarët e familjes të përmendur në nenin 62 të Konventës i paraqesin institucionit të vendbanimit të tyre një vërtetim që dëshmon se i interesuari përfiton të ardhura për papunësi sipas legjislacionit të një Pale tjetër kontraktuese dhe se do kishte të drejtë për të ardhurat për familje po të banonte me anëtarët e familjes së tij në territorin e shtetit kompetent. Ky vërtetim i lëshohet qoftë nga institucioni kompetent në fushën e papunësisë të këtij shteti të fundit, qoftë nga një tjetër institucion i përcaktuar nga autoriteti kompetent i këtij shteti. Nëse anëtarët e familjes nuk paraqesin vërtetimin në fjalë, institucioni i vendbanimit të tyre i drejtohet institucionit kompetent për ta marrë atë.
- 2 Dispozitat e neneve 81 e 82 të Marrëveshjes janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

**Pjesa VI – Dispozita të ndryshme****Neni 84**

Institucioni i vendbanimit të një përfituesi që ka marrë pa të drejtë të ardhura, apo institucioni i përcaktuar nga autoriteti kompetent i Palës kontraktuese në territorin e së cilës banon ky përfitues, tregohet i gatshëm për t'i shërbyer institucionit të çdo Pale kontraktuese që ka dhënë të tilla të ardhura, në rast rekursi të ushtruar nga ky institucion i fundit ndaj përfituesit në fjalë.

**Neni 85**

- 1 Nëse, gjatë likuidimit apo revizionimit të të ardhurave për invaliditet, pleqëri apo vdekje (pensione), në zbatim të Kreut 2 të Pjesës III të Konventës, institucioni i një Pale kontraktuese i ka derdhur një përfituesi të ardhurash një shumë që e tejkalon shumën që ka të drejtë të përfitojë, ky institucion mund t'i kërkojë institucionit të çdo Pale kontraktuese, debitore të ardhurash korresponduese në favor të këtij përfituesi, të mbajë shumën e paguar tepër në prapambetjet që i derdh përfituesit në fjalë. Institucioni i fundit e transferon shumën e mbajtur në këtë mënyrë tek institucioni kreditor. Nëse rekuperimi nuk mund të kryet nëpërmjet pagesave të prapambetura, dispozitat e paragrafit të mëposhtëm janë të zbatueshme.
- 2 Kur institucioni i një Pale kontraktuese i ka derdhur një përfituesi të ardhurash një shumë që e tejkalon shumën që ai ka të drejtë të marrë, ky institucion, brenda kushteve dhe kufizimeve të parashikuara nga legjislacioni që zbaton, mund t'i kërkojë institucionit të çdo Pale kontraktuese, debitore të ardhurash në favor të këtij përfituesi, të mbajë shumën e paguar tepër nga shumat që i derdh përfituesit në fjalë. Institucioni i fundit kryen veprimin e mbajtjes brenda kushteve dhe kufizimeve në të cilat autorizohet një kompensim i tillë nga legjislacioni që ai zbaton, sikur të bëhej fjalë për shumata të shërbyera tepër nga ai vetë, dhe e transferon shumën e mbajtur në këtë mënyrë tek institucioni kreditor.
- 3 Kur institucioni i një Pale kontraktuese ka derdhur një paradhënie të ardhurash për një periudhë gjatë së cilës përfituesi kishte të drejtë të merrte të ardhura në bazë të legjislacionit të një Pale tjetër kontraktuese, ky institucion mund t'i kërkojë institucionit të Palës tjetër të mbajë shumën e paradhënies në fjalë nga shumata që ajo i detyrohet këtij përfituesi për të njëjtën periudhë. Institucioni i fundit kryen veprimin e mbajtjes dhe transferon shumën e mbajtur në këtë mënyrë tek institucioni kreditor.

**Neni 86**

Kur një person ka përfitur nga asistencë sociale në territorin e një Pale kontraktuese për një periudhë gjatë së cilës kishte të drejtë të merrte të ardhura sipas legjislacionit të një Pale tjetër kontraktuese, organizmi që ka dhënë asistencë sociale, nëse ligjërisht ka një rekurs për të ardhurat e përfituesit të asistencës sociale, mund t'i kërkojë institucionit të çdo Pale tjetër kontraktuese, debitore të ardhurash në favor të këtij personi, të mbajë shumën e shpenzimeve të asistencës sociale dhënë gjatë periudhës në fjalë mbi shumata që i derdh po këtij personi. Institucioni i fundit kryen veprimin e mbajtjes dhe transferon shumën e mbajtur në këtë mënyrë tek institucioni kreditor.

**Neni 87**

- 1 Në rastin kur e drejta për të ardhura nuk është njohur nga institucioni i përcaktuar si kompetent, të ardhurat në natyrë që janë dhënë nga institucioni i vendqëndrimit, në bazë të mundësisë së parashikuar në paragrafin 2 të nenit 20 apo në paragrafin 2 të nenit 55 të Marrëveshjes, rimbursohen nga institucioni i parë.
- 2 Shpenzimet e kryera nga institucioni i vendbanimit apo nga institucioni i vendqëndrimit në cilësinë e të ardhurave në natyrë të shërbyera në bazë të dispozitave të paragrafit 1 të nenit 60 të Marrëveshjes, ndërkohë që i interesuari nuk ka të drejtë për të ardhura, rimbursohen nga institucioni që cakton autoriteti kompetent i Palës kontraktuese në fjalë.
- 3 Institucioni që ka rimbursuar të ardhura të padrejta, në bazë të dispozitave të paragrafit 1 apo të paragrafit 2 të këtij neni, ruan mbi përfituesin një kreditim të barabartë me shumën e të ardhurave të shërbyera në mënyrë të padrejtë.

**Neni 88**

Në rast mosmarrëveshjeje midis institucioneve apo autoriteteve kompetente të dy a më shumë Palëve kontraktuese lidhur ose me legjislacionin e zbatueshëm në përputhje me Pjesën II të Konventës, ose me përcaktimin e institucionit që duhet të shërbejë të ardhurat, i interesuari që pretendon për të ardhura, në pamundësi kundërshtimi, përfiton përkohësisht të ardhura të parashikuara nga legjislacioni që zbaton institucioni i vendbanimit apo, nëse i interesuari nuk banon në territorin e një prej Palëve kontraktuese në fjalë, nga legjislacioni i Palës kontraktuese, objekt i së cilës ka qenë më parë, për herë të fundit. Pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes, të ardhurat e shërbyera si të përkohshme i kalojnë në ngarkim institucionit të njohur si kompetent për dhënien e të ardhurave.

**Neni 89**

Nëse institucioni kompetent i një Pale kontraktuese është i mendimit se, për të zbatuar legjislacionin e tij apo Konventën, në raste të caktuara, ka vend për të kryer hetim në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, ai mund të dërgojë një person për të hetuar në këtë drejtim, pasi të jenë marrë vesh autoritetet kompetente të dy Palëve në fjalë. Autoriteti kompetent i Palës kontraktuese në territorin e së cilës kryet hetimi, i jep ndihmën e vet hetuesit në fjalë, duke caktuar konkretisht një person për ta ndihmuar në konsultimin e proçes-verbaleve dhe të krejt dokumenteve të tjera që kanë të bëjnë me rastin e marrë në shqyrtim.

**Neni 90**

Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese konsideron si anëtarë familjeje apo vatre të përbashkët vetëm personat që jetojnë në një shtëpi me të interesuarit, institucioni që zbaton këtë legjislacion mund të kërkojë vërtetimin që këta anëtarë familjeje apo vatre të përbashkët, kur nuk e plotësojnë këtë kusht, janë kryesisht në ngarkim të të interesuarit, nëpërmjet dokumentesh që dëshmojnë se i interesuari subvencionon në mënyrë thelbësore për jetën e tyre.

**Neni 91**

Marrëveshjet që do të arrihen në bazë të paragrafit 1 të nenit 26, të paragrafit 3 apo të paragrafit 6 të nenit 32, të nenit 41, të paragrafit 3 të nenit 42, të paragrafit 5 të nenit 46, të paragrafit 1 të nenit 56, të paragrafit 1 të nenit 58, të paragrafit 2 të nenit 67, të paragrafit 3 të nenit 69, të paragrafit 2 apo të paragrafit 3 të nenit 70 të Konventës, si dhe në bazë të nenit 5 të Marrëveshjes, do t'i transmetohen Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës brenda tre muajve nga data e hyrjes së tyre në fuqi.

**Neni 92**

- 1 Shtojcat e përmendura në nenin 4 të Marrëveshjes janë pjesë përbërëse e kësaj të fundit.
- 2 Çdo amendament që do t'u bëhet Shtojcave të Marrëveshjes, do të notifikohet nga Pala kontraktuese apo nga Palët kontraktuese të interesuara tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.
- 3 Në rast propozimi për amendament që mund t'i bëhet Shtojcës 5 të Marrëveshjes, procedura e parashikuar për paragrafët 2 dhe 3 të nenit 73 të Konventës është e zbatueshme *mutatis mutandis*.

**Pjesa VII – Dispozita kalimtare dhe përfundimtare****Neni 93**

Parazitja e një kërkesë për të ardhurat për invaliditet, pleqëri apo për personat pasjetues pas hyrjes në fuqi të Konventës, pranë institucionit të një Pale kontraktuese sjell, në përputhje me dispozitat e Konventës në fjalë, rishikimin *ex officio* të të ardhurave të likuiduara para hyrjes së saj në fuqi, për të njëjtin eventualitet, nga ana e institucionit apo e institucioneve të një apo shumë Palëve të tjera kontraktuese.

**Neni 94**

- 1 Marrëveshja është e hapur për nënshkrimin e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës nënshkruese të Konventës, që mund të bëhen në të Palë nëpërmjet :
  - a nënshkrimit pa rezervë ratifikimi apo pranimi ;
  - b nënshkrimit me rezervë ratifikimi apo pranimi, pasuar nga ratifikim apo pranim .
- 2 Çdo shtet që nënshkruan Marrëveshjen pa rezervë ratifikimi apo pranimi apo që e ratifikon apo e pranon atë duhet, në të njëjtën kohë, të ratifikojë apo të pranojë Konventën.
- 3 Instrumentet e ratifikimit apo pranimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

**Neni 95**

- 1 Marrëveshja do të hyjë në fuqi në të njëjtën ditë me Konventën.
- 2 Për çdo shtet anëtar që do ta nënshkruaj më pas pa rezervë ratifikimi apo pranimi, apo që do ta ratifikojë apo pranojë, Marrëveshja do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së nënshkrimit apo depozitimit të instrumentit ratifikues apo pranues.

**Neni 96**

- 1 Çdo shtet joanëtar i Këshillit të Evropës që, me ftesë të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, në përputhje me nenin 77 të Konventës, do të aderohet në të, duhet të aderohet njëkohësisht edhe në Marrëveshje.
- 2 Aderimi do të kryet duke depozituar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës një instrument aderimi që do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të tij.

**Neni 97**

- 1 Marrëveshja do të jetë e vlefshme për aq kohë sa dhe Konventa.
- 2 Asnjë Palë kontraktuese nuk mund të denoncojë Marrëveshjen pa denoncuar në të njëjtën kohë vetë Konventën në kushtet e përcaktuara në dispozitat e nenit 78 të kësaj të fundit.
- 3 Denoncimi do të bëhet i efektshëm gjashtë muaj pas datës kur Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës ka marrë notifikimin e këtij denoncimi.

**Neni 98**

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'u notifikojë brenda një muaji Palëve kontraktuese, shteteve nënshkruese, si dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës ndërkombëtare të Punës :

- a çdo nënshkrim pa rezervë ratifikimi apo pranimi ;
- b çdo nënshkrim me rezervë ratifikimi apo pranimi ;
- c depozitimin e çdo instrumenti ratifikues, pranues apo aderues ;
- d çdo datë të hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, në përputhje me dispozitat e neneve 95 e 96 të saj;
- e çdo notifikim të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 97 të Marrëveshjes dhe datën në të cilën denoncimi do të bëhet i efektshëm ;
- f çdo komunikim apo notifikim të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 91 dhe të paragrafit 2 të nenit 92 të Marrëveshjes.



Për të dëshmuar këtë, të nënshkruarit, rregullisht të autorizuar për këtë qëllim, nënshkruan këtë Marrëveshje plotësuese.

Bërë në Paris, më 14 dhjetor 1972, në frëngjisht dhe në anglisht, ku të dy tekstet janë njëlloj të vërtetë, në një kopje të vetme që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'i transmetojë kopje të vërtetuar secilit prej shteteve nënshkruese dhe aderuese.

## **SHTOJCAT**

(Teksti nuk është dhënë)